



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

*Universiteti
Fakulteti
Programi Studimor*

***Universiteti i Evropës Juglindore
Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore
Zbatimi i teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK) në procesin
mësimor***

TEZA E MAGJISTRATURËS

NDIKIMI I RRJETEVE SOCIALE NË EDUKIM: STUDIM RASTI I SHKOLLAVE TË MESME NË FERIZAJ

Kandidate
Vlora Bytyqi

Mentor
Prof. Dr. Xhemal Zenuni

Gusht, 2020

Abstrakt

Zhvillimi i avancuar i teknologjisë ka bërë që këto vitet e fundit rrjetet sociale të jenë mjetet më të rëndësishme të komunikimit në mes njerëzve duke përfshirë të gjitha nivelet e ndjekjes arsimore.

Sot rrjetet sociale kanë ndikuar se si njerëzit e shohin botën, miqësinë, komunikimin, edukimin dhe qasjen ndaj informacioneve të reja dhe ato ekzistuese. Më të prekur nga ky fenomen duket të jenë gjeneratat e reja.

Mësimnxënia dhe mësimdhënia poashtu kanë ndryshuar qasjen e nxënësve, respektivisht të mësimdhënësve. Tani ka ndryshuar puna bashkëpunuese dhe ndërveprimi mes të dyja palëve. Kjo ka bërë që fryma bashkëpunuese të jetë më e madhe në grupe nxënësish, ku ata kanë mundësinë të komentojnë, diskutojnë, krijojnë informacione si dhe të jenë me të motivuar për mësimnxënien.

Përmbledhja e këtij punimi është bërë duke u bazuar nga përzgjedhja e disa artikujve shkencor që kanë trajtuar shumë çështje me ndikim për rrjetet sociale, duke veçuar ndikimin e rrjeteve sociale në edukim dhe nga hulumtimi me anë të pyetësorëve që është bërë në shkollat e mesme në qytetin e Ferizajt.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është vlerësimi i impaktit pozitiv apo negativ të rrjeteve sociale në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, dhe inkurajimi apo vetdijësimi i nxënësve për përdorimin e rrjeteve sociale në arsim.

Fokusi i studimit është të përcaktoj efektin e rritjes së përdorimit të rrjeteve sociale me anë të të nxënës bashkëpunues në procesin mësimor.

Përmbajtja

Abstrakti.....	2
Përmbajtja	3
Lista e figurave	5
1. Hyrja	7
1.1 Shtrimi i problemit.....	9
1.2 Qëllimi/Synimi.....	9
1.3 Objektivat e studimit.....	9
1.4 Hipotezat	9
2. Evoluimi i rrjeteve sociale ndër vite	10
2.1 Përkufizimi i rrjeteve sociale	10
2.2 Historia e rrjeteve sociale.....	10
2.3 Rritja e shpejtë e Internetit.....	12
2.4 Roli i etikës në rrjetet sociale.....	15
2.4.1 Kontrolli i privatësi së në rrjetet sociale	15
2.4.2 Pandershmëria dhe shtrembërimi.....	16
2.4.3 Sjellja e përdoruesit dhe përgjigjësia e rrjeteve sociale	16
2.4.4 Rreziku i integritetit	16
3. Rishikimi i literaturës.....	18
3.1 Metodatat hulumtuese.....	18
3.2 Gjetjet dhe rezultatet	18
3.3 Ndikimet negative dhe pozitive të rrjeteve sociale	20
3.4 Roli i mësimdhënësit në rrjetet sociale	20
3.5 Përfundimi dhe rekomandimet e autorëve	27
4. Studim rasti- shkollat e mesme në Ferizaj	29

4.1 Rezultatet e anketës me nxënës.....	29
4.1.1 Konkluzione nga anketa me nxënës.....	41
4.2 Rezultatet e anketës me mësimdhënës.....	42
4.2.1 Konkluzione nga anketa me mësimdhënës.....	47
Përfundimi.....	49
Bibliografia.....	52
Shtesat.....	55

Lista e figurave

Figura 1: Historia e rrjeteve sociale nga viti 1978-2015

Figura 2: Përdoruesit e rrjeteve sociale nga 2010 deri më 2019

Figura 3: Përdorimi i internetit nga viti 2001-2015

Figura 4: Përdorimi i mediave sociale për mësim online dhe jo online

Figura 5: Përdorimi i mediave sociale sipas faqeve të tyre

Figura 6: Numri i orëve që shpenzojnë në media sociale brenda ditës

Figura 7: Shpërndarja e të anketuarve sipas gjinisë

Figura 8: Shpërndarja e të anketuarve sipas moshës

Figura 9: Shpërndarja sipas posedimit të telefonave të mençur

Figura 10: Shpërndarja sipas informatave për rrjetet sociale

Figura 11: Përgjigjja e nxënësve se cilin rrjet social përdorin më shumë

Figura 12: Koha e shpenzuar në rrjetet sociale nga nxënësit

Figura 13: Koha e shpenzuar në rrjetet sociale për mësim

Figura 14: Përdorimi i rrjetetve sociale për komunikim dhe informacion

Figura 15: Përdorimi i rrjeteve sociale për foto dhe video

Figura 16: Përdorimi i rrjeteve sociale për të mësuar

Figura 17: Rezultatet rreth trajnimeve për rrjetet sociale

Figura 18: Komunikimi i mësimdhënësve dhe nxënësve përmes rrjeteve sociale

Figura 19: Suksesi i nxënësve në mësim nga përdorimi i SNS-ve

Figura 20: Përgjigjjet për abuzimet dhe ngacmimet nëpër rrjete sociale

Figura 21: Sa neglizhohet mësimi duke kaluar kohë në internet

Figura 22: Njoftimi i prindërve për shpenzimin e kohës në internet

Figura 23: Ndikimi i internetit në notat e nxënësve

Figura 24: Siguria në rrjetet sociale

Figura 25: Përdorimi i rrjeteve sociale-vështirësi në komunikimin ballë për ballë

Figura 26: Rezultatet sipas gjinisë

Figura 27: Posedimi i telefonave të mençur nga mësimdhënësit

Figura 28: Njohuritë rreth rrjeteve sociale nga mësime dhënësit

Figura 29: Përdorimi i rrjeteve sociale nga mësime dhënësit

Figura 30: Arsyeja e përdorimit të rrjeteve sociale nga mësime dhënësit

Figura 31: Inkurajimi i nxënësve nga mësime dhënësit

Figura 32: Përdorimi i SNS-ve lehtëson punën e mësime dhënësit

Figura 33: Ndikimi i SNS-ve në suksesin e nxënësve

Figura 34: Përdorimi i tepërt i SNS-ve vështirëson të shprehurit dhe komunikimin

1. Hyrje

Me zhvillimin e shpejtë të teknologjisë dhe internetit dolën në pah të ashtuquajturat rrjetet sociale ku tani në këtë dekadë që po jetojmë këto rrjete njihen si teknologjitë më të popullarizuara dhe më të përdorura në mbarë botën duke përfshirë të gjitha moshat.

Këto rrjete njihen si sociale përshkak se përdoruesit mund të shfaqin jetën e tyre shoqërore, ndërsa komunikimi është arsyeja kryesore mes përdoruesve. Me anë të këtyre rrjeteve sociale përdoruesit kanë mundësi që të ndajnë informacione të ndryshme me të tjerët po ashtu të kenë qasje më të shpejtë në informacione të reja, duke përfshirë foto, video etj.

Pra, në përgjithësi mund të themi se rrjetet sociale kanë ndikuar dukshëm në mënyrën se si jetojmë tani, si bashkëveprojmë me komunitetin tonë, si e marrim dhe si e ndajmë informacionin.

Aktualisht sipas një studimi të shqyrtuar në artikujt e më poshtëm rrjetet sociale më të njohura janë Facebook, Twitter, Google+, Snapchat, etj [1].

Këto rrjete u bënë të njohura nga fillimi i operimit të Facebook dhe My Space, pra nga viti 2004 dhe 2006, ku gjithçka filloi nga themeluesi i Facebook ku fillimisht krijoi një faqe vetëm për studentët e Harvardit ku ai ndiqte studimet në atë kohë. Por më pas Facebook u popullarizua në mbarë botën duke u bërë rrjeti social më i njohur.

Ashtu siç u cekë më lartë, këto rrjete sot përdoren nga të gjitha moshat, por ajo çka neve na intereson në këtë studim është përdorimi i këtyre rrjeteve nga nxënësit dhe studentët dhe ndikimi i tyre në performancën e tyre akademike.

Sot rrjetet sociale studentët i shohin si mjetet kryesore të komunikimit, bashkëveprimit shoqëror dhe profesional në mes vete. Studentët dhe nxënësit sot mund ti qasen më shpejt dhe më lehtë informacionit pavarësisht distancës ku ata ndodhen apo ku jetojnë.

Falë zhvillimit të teknologjisë dhe rrjeteve sociale në veçanti, ata mund të ndjekin kurse online që ligjërohen nga ana e mësimitdhënësve, mund të organizojnë aktivitete të ndryshme, ushtrime në grupe dhe thjesht organizimi apo mënyra e të mësuarit është bërë më atraktive.

Poashtu teknologjia e fundit e njohur si Web 2.0 në rrjetet sociale ka bërë që të rritet akoma më shumë numri i përdoruesve të SNS-ve (Social Network Site) për qëllime personale apo edhe për qëllime edukativo-arsimore.

Sipas një studimi [2] përdorimi i telefonit të mençur ka rritur poashtu përdorimin e rrjeteve sociale. Sipas po të njejtit studim, përdoruesit mund të hyjnë në faqet e shumta të rrjeteve sociale në mënyrë më të lehtë dhe më praktike.

Për përdorimin e rrjeteve sociale nga ana e studentëve janë bërë hulumtime të shumta dhe pjesa më e madhe e hulumtimeve kanë treguar rezultate pozitive. Disa studime kanë dëshmuar se rrjetet sociale ndikojnë negativisht në performancën e studentëve siç ishte rasti i një universiteti në Gana [3], ndërkohë që sipas disa hulumtimeve tjera rrjetet sociale përmirësojnë të mësuarit dhe aftësitë e komunikimit [4].

Sot në botë, mbi një miliard njerëz përdorin SNS-të që të jenë në kontakt me miqtë, familjarët dhe kolegët e tyre që ndajnë interesa të përbashkëta, që ndajnë dhe marrin informacione, krijojnë përmbajtje, etj [5].

SNS-të në arsim nuk janë vetëm funksionale në bashkëveprimin social dhe komunikim, por përdoren edhe për organizimin e aktiviteteve të të mësuarit duke bërë video prezantime të ndryshme dhe ushtrime tjera grupore për një kurs të caktuar. Përveç kësaj, përdorimi i SNS-ve së bashku me mësimdhënësit u mundësojnë nxënësve të bëhen më të vetëdijshëm për mundësitë arsimore duke shfrytëzuar rrjetet sociale si mjete bashkëpunuese. Dihet se përdorimi i SNS-ve ka shumë përfitime, por ka gjithashtu edhe të metat e përdorimit në mjediset arsimore. Shembull, nëse një mësimdhënësi përdor SNS-të për të mbështetur kurset e tij/saj në shkollë, administrata e shkollës sigurisht do të duhej të monitoronte me kujdes përdorimin e SNS-së pasi që mësimdhënësi është një përfaqësues i shkollës së tij/saj në publik. Për më tepër, një koment i patolerueshëm i bërë nga ana e nxënësve në SNS-të do të ndikonte tek karriera e mësimdhënësit, për më tepër mund të ndikoj edhe tek reputacioni i institucionit arsimor [3].

Për përdorimin e SNS-ve në institucionet arsimore, rekomandohet të përcaktohen rolet dhe rregullat që duhen ndjekur nga mësimdhënësit dhe nxënësit. Në disa hulumtime u konstatua se përdorimi i rrjeteve sociale ka pasur një ndikim negativ në performancën akademike të studentëve [3]. Poashtu në këtë hulumtim u konstatua se studentët SNS-të as nuk i mendonin si një mjet të dobishëm në arritjen e qëllimeve të tyre akademike, gjithashtu studentët nuk besonin se SNS-të duhet të integrohen në procesin arsimor [3].

1.1 Shtrimi i problemit

Zhvillimi i teknologjisë në përgjithësi dhe rrjetet sociale në veçanti janë një mundësi e mirë e institucioneve arsimore dhe nxënësve që të ngrisin performancën e tyre akademike duke përdorur këto rrjete në mënyrën e duhur, por problemi tek ne është se sa janë të informuar dhe të trajnuar nxënësit dhe mësimmshënësit për përdorimin e këtyre rrjeteve në edukim.

1.2 Qëllimi/Synimi

Qëllimi i hulumtimit në këtë punim është që të nxirren rezultate se sa dhe si përdoren rrjetet sociale nëpër shkolla tona dhe nëse përdoren ato, sa kanë ndikuar në rezultatet e nxënësve nëse ata kanë kaluar kohë në këto vende duke mësuar. Po ashtu synohet të bëhet analizimi analitik dhe statistikor i rezultateve të fituara me anë të hulumtimit dhe arritja e një konkluzioni për këto rezultate.

Qëllimi kryesor është informimi apo edhe inkurajimi i nxënësve që rrjetet sociale ti përdorin për ti rritur njohuritë e tyre edukative, jo vetëm për argëtim apo qëllime tjera.

1.3 Objektivat e studimit

Objektiv i studimit është të marr informacione dhe të vlerësoj se sa përdoren rrjetet sociale për qëllime edukative/arsimore në shkollat e caktuara në komunën e Ferizajt.

Gjithashtu një aspekt tjetër që mundohet të trajtohet në këtë studim është efekti dhe impakti i SNS-ve. Gjithashtu tentohet të vihet në pah që nxënësit sa dhe si i përdorin këto rrjete për të mësuar.

1.4 Hipotezat

1. Rrjetet sociale ndikojnë negativisht në procesin mësimor.

Të rinjtë i përdorin mjaft shumë rrjetet sociale por supozimi është se ata i përdorin për komunikim dhe argëtim, por jo edhe për mësimnxënie. Si rezultat shfrytëzimi i rrjeteve sociale në këtë mënyrë ju merr kohën për punë individuale dhe mësimnxënie.

2. Rrjetet sociale përdoren nga nxënësit më shumë për argëtim se sa për të fituar njohuri akademike.

Në lidhje me vërtetimin e këtyre hipotezave do të trajtohen disa faktorë që i kemi listuar më poshtë, faktorë të cilët do të merren parasysh nga hulumtimi që do të bëhet në shkollat e mesme në Ferizaj me anë të një pyetësi.

- Të menduarit kritik
- Humbja e kohës

- Largimi nga bota reale
- Vështirësi në komunikim
- Shkaktimi i shpërqendrimit

2. Evoluimi i rrjeteve sociale

2.1 Përkufizimi i rrjeteve sociale

Rrjetet sociale janë mjete teknologjike të komunikimit që përdoren nga njerëzit të cilët marrin dhe shpërndajnë informacione të ndryshme, mesazhe, përmbajtje, foto, video etj.

Pas krijimit të internetit dhe përdorimit të tij u bënë të njohura edhe rrjetet sociale, me çka kuptojmë se rrjetet sociale hyjnë në grupin e platformave që përfshijnë komunikimin online.

2.2 Historia e rrjeteve sociale

Zhvillimi i teknologjisë së komunikimit ka filluar nga fundi i shekullit të 19-të. Telegrafi i parë i Samuel Morse, të cilin ai e dërgoi në 1844 midis Uashington D.C dhe Baltimore ishte një shembull i teknologjisë së komunikimit [1].

Megjithatë ky lloj komunikimi nuk u cilësua si rrjet social pasi që nuk ishte online dhe nuk mund të lidhte ndonjë komunitet më të madh të përdoruesve. Ata dërguan mesazhe individuale mes dy njerëzve. Historia e vërtetë e rrjeteve sociale filloi në vitet 1970 pas shfaqjes së internetit [1].




Figura 1: Historia e rrjeteve sociale nga viti 1978-2015 [32]

Në figurën 1 është paraqitur evoluimi i rrjeteve sociale nga viti 1978 deri në vitin 2015. BBS apo ndryshe siç u quajt Sistemi i Bordit të Buletinit ishte rrjeti i parë social që u shfaq në fund të vitit 1970 dhe lejonte lidhjen e përdoruesve ndërmjet veti [1].

Disa vite më pas u shfaq Sistemi Usenet në vitin 1979 [1]. Internet Relay Chat (IRC) u përmend për herë të parë në 1988. Six Degrees është platforma e parë e mediave që doli në vitin 1997 [1]. Pas këtij viti u lansuan faqe tjera si Asianavane, Migente dhe Blackplanet. Përdoruesit mund të krijojnë profile personale ose profesionale.

Këto media sociale që u përmendën më lartë nuk ishin aq të njohura sa janë tani rrjetet sociale moderne sepse teknologjia nuk ishte shumë e avancuar në atë kohë.

Friendster është konsideruar rrjeti i parë social që u themelua në vitin 2002 [1]. Pas tij u shfaq LinkedIn në vitin 2003 dhe ishte rrjeti kryesor i bizneseve dhe kompanive të ndryshme. Gjiashtu në vitin 2003 u shfaq edhe rrjeti tjetër social që ishte Hi5 [1].

Në vitin 2004 u lansua për herë të parë Facebook i cili pas vitit 2008 mori një popullaritet të madh ku edhe sot konsiderohet si platforma më e njohur e rrjeteve sociale [1].

Poashtu në vitin 2004 u krijua edhe rrjeti social My Space i cili u rrit me shpejtësi të madhe deri në vitin 2006, por më pas Facebook dhe rrjetet tjera sociale dominuan para tij [1].

Në vitin 2005 u lansua Youtube dhe tani Youtube është shumë e njohur dhe e përdorur për shfaqjen e përmbajtjes së videove të ndryshme.

Në vitin 2006 u krijua rrjeti social Twitter i cili sot është shumë i njohur dhe ka mjaft shumë përdorues [1]. Në vitin 2010 u krijua Instagram, një platformë e përdorur mjaft nga të rinjtë i cili më pas u ble nga Facebook.

Kështu përdorimi i rrjeteve sociale ishte rritur nga viti në vit dhe në vitin 2019 kemi rreth 2.82 miliard përdorues ku sipas forumit ekonomik në vitin 2020 pretendohet që rrjetet sociale do të kenë rreth 2.95 miliard përdorues [1].

2.3 Rritja e shpejtë e Internetit

Interneti filloi operimin nga viti 1960 dhe 1970, ku aty filloi edhe mundësia për shfaqjen e rrjeteve sociale, por përdorimi i kompjuterëve personal u rrit shumë pas viteve 1990 me çka edhe rrjetet sociale u popullarizuan më shumë [1].




Figura 3: Përdorimi i internetit nga viti 2001-2015 [1]

Në vitin 2000 rrjetet sociale u zhvilluan me shpejtësi të madhe dhe kjo bëri që njerëzit të shohin si mundësi e shkëlqyer komunikimi, bashkëpunimi në të gjitha sferat duke përfshirë biznesin, edukimin, shoqërinë, miqësinë etj.

Siç shihet nga figura 3 numri i përdoruesve të internetit është rritur çdo vit dhe vazhdon të rritet akoma.

Dy faqet e para të rrjeteve sociale ishin Six Degrees dhe Friendster të cilat kishin një ndikim mjaft të madh pas shfaqjes së tyre. Pas tyre u shfaqen edhe rrjete sociale të tjera e kjo bëri që këto rrjete të bien gradualisht deri në mbylljen e tyre. Në përgjithësi, rreth 2.62 miliardë njerëz janë përdorues të rrjeteve sociale në mbarë botën, ku numri i përdoruesve pritet të rritet akoma në vitet e ardhshme [1].

Në vazhdim do ti paraqesim faqet më të popullarizuara të rrjeteve sociale ndër vite.

Six Degrees

Six Degrees u themelua më 1997 dhe ishte faqja e parë e rrjetit social ku përdoruesit mund të krijonin profilet e tyre personale. Në fillim kishte mjaft përdorues dhe rritej vazhdimisht por më vonë u mbyll diku në vitin 2001[1].

Friendster

Pas mbylljes së Six Degrees doli në pah një tjetër rrjet social siç ishte Friendster, njëjtë sikurse faqja Six Degrees edhe kjo lejonte përdoruesit të krijonin profile personale, të komunikojnë përdoruesit, të ndanin informacione etj. Me gjithë këto përparësi kjo bëri që Friendster të rritet vazhdimisht ku kaloi shifrën mbi njëqind milion përdorues.

Më pas me popullarizimin e rrjeteve sociale siç ishin Facebook e shumë të tjera ndikoi që kjo faqe të mbyllet zyrtarisht më 1 Janar 2019 [1].

LinkedIn

LinkedIn është rrjet social i fokusuar kryesisht në rrjetin e bizneseve dhe kompanive të ndryshme ku edhe sot operon në formë të këtyre. Momentalisht LinkedIn ka më shumë se 500 milion përdorues[1]. LinkedIn u themelua më 28 dhjetor 2002 nga Reid Hoffman, Allen Blue, Konstantin Guericke, Eric Ly dhe Jean-Luc Valliant [1].

My Space

My Space u themelua më 1 gusht 2003 dhe është një nga rrjetet sociale që ka pasur vazhdimisht rritje të numrit të përdoruesve. Duke e parë si një rrjet social mjaft i përdorur rezultoi deri në shkitjen e tij ku deri në vitin 2006 ishte faqja më e vizituar sociale [1]. Pas themelimit të Facebook përdorimi i My Space filloi të bie duke u zëvendësuar nga Facebook si rrjeti më i përdorur. Krahas kësaj My Space operon edhe sot me një numër të lartë të përdoruesve.

Facebook

Facebook u themelua më 4 shkurt 2004 nga Mark Zuckerberg, Eduardo Saverin, Andrew McCollom, Dustin Moskovitz dhe Chris Hughes. Facebook filloi si një faqe e rrjeteve sociale vetëm për studentët e Harvardit ku Zuckerberg ishte student në këtë universitet në atë kohë.

Pas vitit 2006 Facebook zgjeroi përdorimin e tij dhe vazhdimisht numri i përdoruesve rritej nga të gjitha moshat. Përdoruesit e Facebook mund të krijojnë profile personale dhe profesionale, shkëmbejnë mesazhe, foto, video duke u bërë kështu rrjeti social më i përdorur nga të gjitha grupmoshat.

Në vitin 2012 Facebook u vlerësua si një nga kompanitë më të mëdha të teknologjisë në të gjitha kohërat [1]. Facebook i kaloi të gjitha rrjetet sociale me numër të përdoruesve dhe aktualisht numëron 2.3 miliard përdorues dhe vazhdon të rritet akoma [1].

Twitter

Twitter u krijua më 21 Mars 2006 nga Jack Dorsey, Noah Glass, Biz Stone dhe Evan Williams [1]. Aktualisht Twitter ka mbi 300 milion përdorues aktiv dhe është një rrjet social mjaft i praktikuar nëpër shkolla dhe universitete të ndryshme botërore.

Instagram

Instagram u krijua më 6 tetor 2010 nga Kevin Systrom dhe Mike Krieger duke u fokusuar më shumë në foto dhe video. Nga shfaqja e tij Instagram është rritur vazhdimisht duke e qar numrin e përdoruesve rreth 1 miliard [1].

Duke parë përdorimin e tij Facebook shfaqti interesimin për ta blerë atë dhe përfundimisht e bleu në vitin 2012.

Snapchat

Snapchat u themelua nga Evan Spiegel, Bobby Murphy dhe Reggie Brown në shtator të vitit 2011[1]. Snapchat i lejoi përdoruesit të shpërndanin fotografi me njëri-tjetrin që do të zhdukeshin pak pasi u hapën.

Sot, përveç këtij shërbimi, Snapchat gjithashtu lejon njerëzit të bisedojnë me njëri-tjetrin, u jep përdoruesve mundësinë për të postuar foto dhe video. Snapchat është i popullarizuar mjaft shumë mes të rinjëve dhe dita ditës po shtohen përdorues të rinjë.

YouTube

YouTube u themelua në vitin 2005 dhe është një platformë shumë e rëndësishme dhe e përdorur për të krijuar dhe shikur videot ekzistuese duke përfshirë video muzikore, klipe të filmave dhe shumëllojshmëri të përmbajtjeve që kanë krijuar përdoruesit.

Në vitin 2006 Youtube u ble nga Google Inc dhe aktualisht operon në kuadër të saj. Sipas hulumtimeve të bëra videot në Youtube mund të jenë udhëzues shumë të mirë për të zgjidhur shumë probleme të ndryshme përfshirë këtu edhe zgjidhjen e problemeve të caktuara edukativo arsimore.

2.4 Roli i etikës në rrjetet sociale

Rrjetet sociale kanë një shtrirje shumë më të gjerë përtej marketingut dhe teknologjisë. Ekzistojnë rregulla të etikës për rrjetet sociale që duhet të ndiqen. Etika, sipas përkufizimit, është koncepti i asaj që është e drejtë dhe e gabuar. Në rrjetet sociale, etika e duhur është e barabartë me perspektivën e duhur dhe me të menduarit e duhur se si të shfrytëzohen rrjetet sociale në mënyrë të përshtatshme dhe si të angazhohen njerëzit në mënyrën e duhur.

Etika është një kod i sjelljes brenda kontekstit të shoqërisë sonë. Në rrjetet sociale, etika e duhur është e barabartë me veprimin e duhur. Ka patjetër një mënyrë të drejtë dhe një mënyrë të gabuar për të përdorur rrjetet sociale.

Është shumë e rëndësishme të mbani mend se sa herë që lidheni me një rrjet social, ju jeni duke iu bashkuar një komuniteti. Në çdo komunitet, ka rregulla të caktuara të sjelljes. Duhet të jeni të sigurtë që t'i trajtoni njerëzit në komunitetin tuaj me respekt dhe dashamirësi.

Është me rëndësi të madhe të respektojmë kufijtë e të tjerëve. Motivimi juaj për të qenë pjesë e komunitetit është që të krijoni marrëdhënie me anëtarët e tjerë të komunitetit tuaj.

Megjithatë me ngritjen e rrjeteve sociale, dilemat etike po rriten duke përfshirë shkeljen e privatësisë, keqinterpretimin, ngacmimin dhe mërzinë. Kur konsumatorët janë duke u bërë objekt i komunikimeve sociale relativisht të pakufizuara ata janë duke u bërë më të prekshëm nga mashtrimet që është bërë arsyeja e vëmendjes për etikën e rrjeteve sociale. Disa nga dilemat etike të hasura kur njerëzit e ndryshëm përdorin rrjetet sociale janë dhënë më poshtë:

2.4.1 Kontrolli i privatësisë në rrjetet sociale

Nëse veprimet që shkelin rregullat për kushtet e privatësisë të çdo përdoruesi të rrjetit shoqëror, dëmtojnë individët ose kredibilitetin profesional duhet të konsiderohet jo etike. Shkelja e privatësisë do të përfshinte çdo qasje jo të lejuar për të marrë ndonjë lloj informacioni personal apo ndonjë lloj tjetër për një individ që mund ta dëmtojë atë ose ta prekë atë në ndonjë kuptim. Megjithatë, ardhja e rrjeteve sociale në të vërtetë çoi në një rritje në kontrollet e privatësisë në internet. Duke e bërë të lehtë përcaktimin e një rrjeti miqësh, rrjetet sociale i lejonin përdoruesit të kontrollonin se kush mund dhe nuk mund të shihte informacionin që postojë në internet. Megjithatë shumë përdorues nuk përfitojnë nga këto kontrolle të privatësisë, përdoruesit sot janë më mirë se ata që ishin në ditët e para të internetit, kur postimi i diçkaje në linjë nënkuptonte ndarjen e tij me të gjithë botën dixhitale.

Ndërsa diskutojmë etikën e rrjeteve sociale, targetimi i sjelljes është një fushë e diskutueshme për t'u marrë në konsideratë. Pika pozitive është se shikuesit mund të vlerësojnë rëndësinë e materialeve që u reklamohen atyre, por kjo është një lloj pushtimi i privatësisë.

Rrjetet sociale shpesh ofrojnë parametra të fuqishëm të privatësisë, përdoruesit zakonisht nuk i shfrytëzojnë këto benefite dhe shumë shpesh janë pre e keqpërdorimit të privatësisë së tyre. Meqenëse është në interes të rrjeteve shoqërore që të mbajnë profilet sa më publik të jetë e mundur, për të inkurajuar shfletimin dhe rrjetëzimin, përdoruesit ekspozohen automatikisht në sy të publikut sapo të regjistrohen, dhe injoranca e tyre dhe vetëkënaqësia zakonisht i mbajnë në atë mënyrë.

2.4.2 Pandershmëria dhe shtrembërimi

Nuk ka metodë të mjaftueshme për të vërtetuar ndershmërinë dhe vërtetësinë e aktiviteteve të rrjetëzimit social të përdoruesve. Synimet e përdorimit të rrjeteve sociale përfshijnë transparencën e komunikimeve dhe postimeve të aktiviteteve të tjera përmes SNS-ve. Është joetike të jesh i pandershëm për ndonjë gjë edhe në rrjetet sociale. Pra, nëse do të bëni pretendime të pandershme rreth vetes ose ndonjë gjëje tjetër ose do të komentoni në mënyrë fyese, do të ndikojë në veten ose kompaninë tuaj në fund. Duke bërë aktivitete të tilla po rrezikohet reputacioni personal dhe emri i kompanisë suaj. Pra, të gjithë duhet ta mbajmë etikën përpara përdorimit edhe kur përdorim mediat sociale.

2.4.3 Sjellja e përdoruesve dhe përgjegjësia e rrjetit social

Rrjetet sociale ofrojnë shumë parametra për privatësi. Megjithatë, përdoruesit rrallë shqetësohen për t'i ndryshuar ato. Përveç kësaj, përdoruesit shpesh ndihen tepër të sigurtë në internet.

Përdoruesit duhet të jenë më të përgjegjshëm për atë që cilësimet e privatësisë zgjedhin, por shumë prej tyre mund të mos jenë të vetëdijshëm për çështjet e privatësisë në rrjetet sociale. Përdoruesit duhet të bëhen më të ditur në këtë aspekt, por rrjetet sociale duhet të merren me realitetin e sjelljes së përdoruesit. Meqë përdoruesit tentojnë të mos ndryshojnë cilësimet e tyre, rrjetet sociale duhet të kufizojnë më shumë parametrat e privatësisë së parazgjedhur dhe t'i kujtojnë përdoruesit për t'i ndryshuar ato.

Ndonjëherë përdoruesit përpiqen të mbrojnë veten sa më mirë që munden dhe një rrjet social nuk arrinë të bëjë pjesën e vet. Një studim mbi adoleshentët që përdorin MySpace zbuloi se 66% e tyre kanë qasje të kufizuar në profil, dhe se rreth gjysma e atyre me profile publike kanë dhënë informacione të rreme [5]. Vendosija e një profili për të qenë privat nuk është tërësisht efektiv në MySpace, madje edhe një profil krejtësisht privat do të tregojë ende disa të dhëna personale, emri, gjinia dhe vendlindja.

2.4.4 Rreziku i integritetit

Në një studim të IBE të kompanive të mëdha 4nga 7 kompani të anketuar identifikuan rrezikun e integritetit si sfidën kryesore etike në lidhje me rrjetet sociale [5]. Kur një punonjës përdor rrjetet sociale në një mënyrë të papërgjegjshme ose në emër të kompanisë ose nëpërmjet llogarisë së tyre personale të rrjeteve sociale, ajo mund të minojë angazhimin e kompanisë ndaj praktikës etike dhe ta ekspozojë atë ndaj rrezikut të integritetit. Rasti i Nestle jep një shembull [6]. Në mars të vitit 2011, një punonjës i cili po menaxhonte përmbajtjen në Facebook Fan Page të kompanisë, bëri komente fyese si përgjigje ndaj vërejtjeve negative nga konsumatorët. Sjellja e punonjësit shkeli parimin e biznesit të integritetit dhe angazhimin e tyre për të "shmangur ndonjë sjellje që mund të dëmtojë ose rrezikojë Nestle-in ose reputacionin e saj" dhe provokoi një reagim ndaj konsumatorit. Midis thirrjeve për të bojkotuar Nestle, anëtarët e publikut të gjerë u bashkuan gjithashtu me Fan Page në mënyrë specifike për të kritikuar kompaninë [6]. Përndryshe, punonjësit mund të postojnë komente negative për kompaninë në profilin e tyre personal të rrjeteve sociale. Kjo është më e vështirë për kompanitë që të kontrollojnë. Anketa e DLA Piper zbuloi se një e treta e punëdhënësve kishin disiplinuar stafin për komentet e papërshtatshme rreth kompanisë në faqet e rrjeteve sociale [6].

3. Rishikimi i Literaturës

Objektivë studimi i këtij kapitulli është që të marr informacione se sa përdoren rrjetet sociale për mësim nëpër universitete të ndryshme botërore dhe si kanë ndikuar ato në procesin mësimor.

3.1 Metoda e hulumtimit

Gjatë shfletimit të artikujve që janë vendosur tek referencat mbi ndikimin e rrjeteve sociale në edukim pothuajse në shumicën e metodave hulumtuese ka qenë pyetësi si instrument që është përdorur për gjetjen e rezultateve nëpër universitete dhe shkolla të mesme në vende të ndryshme të botës. Si objektivë studimi ishte diskutimi i rezultateve të mbledhura duke shqyrtuar ndikimin e SNS-ve në institucionet arsimore.

3.2 Gjetjet dhe rezultatet

Fillimisht do të paraqesim rezultatet e një ankete që u bë në Universitetin për Teknologji në Malajzi. Hulumtimi u bë me anë të një pyetësi në vitin 2012/2013 ku rreth 80 student universitar morrën pjesë nga mosha 18 dhe 36 vjeç [4].

Studentët duhet të japin informacione në lidhje me ndikimin e rrjeteve sociale në performancën e tyre akademike dhe mënyrën se si ata bashkëpunonin në grupe studentore duke përdorur rrjetet sociale.

Ky hulumtim nxori rezultate negative lidhur me përdorimin e rrjeteve sociale në këtë Universitet. Sipas tyre ata student që përdornin rrjetet sociale duke veçuar këtu Facebook humbisnin kohën e tyre duke u argëtuar dhe si rezultat kishin nota më të dobëta në krahasim me ata student që nuk përdornin rrjetet sociale [4].

Sipas këtij studimi rrjetet sociale ishin një shpërqëndrim i madh për studentët.

Sipas hulumtimit varësia nga interneti dhe nga faqet e rrjeteve sociale ku adoleshentët kanë përdorur këto faqe interneti për të qenë në gjendje të kontaktojnë kolegët e tyre, të ndajnë informacione, dhe të shfaqin jetën e tyre shoqërore por jo duke përdorur dobinë e teknologjisë për të përmirësuar performancën e tyre në mësim, e shihnin si një rrezik të madh për gjeneratat e reja. Hulumtuesit në fund kishin një sugjerim për studentët dhe nxënësit rreth përdorimit të rrjeteve sociale. Ata u rekomanduan nxënësve një bashkëpunim më të madh me mësimdhënësit e tyre rreth përdorimit të rrjeteve sociale, i cili bashkëpunim do të rezultonte në rritjen e performancës akademike të studentëve [4].

Rrjetet sociale në arsim përfshijnë Facebook, Twitter, Linked-in, Google+ etj, ndër të cilat Facebook udhëheq pjesën më të madhe të përdorimit. Në vitin 2008-2009 rreth 61% e popullsisë përdornin Facebook dhe ky numër në vitin 2009/2010 arrinë në 87% dhe në vitet 2010/2011

arrin 98% në [7]. Institucionet arsimore kanë përdorur më së shumti “microblogging” për njoftuar studentët dhe mësuesit me njoftimet e fundit [7].

Shkollat po zbatojnë teknologjinë e rrjeteve sociale për qëllime pedagogjike dhe është një arritje që ka marrë shumë përkrahje dhe rezultate [7].

Sipas studimit të Dr. Islam, shumë faktorë kanë ndikuar tek përdorimi i rrjeteve sociale siç janë koha e kaluar në studime, ndjekja e rregullt e klasës, mbështetja dhe përfshirja e prindërve, interesimi për lëndët kryesore të studimit dhe kjo rezulton në ngritjen e performancës akademike të nxënësve [7].

Sipas këtij studimi [7] faqet më të popullarizuara të rrjeteve sociale janë:

1. Facebook: Krijon një hapësirë për studentët që të pyesin dhe t'i përgjigjen pyetjeve. Me anë të Facebook-ut studentët mund të bëjnë punë grupore rreth kurseve të caktuara. Mësimdhënësit gjithashtu mund ta përdorin në klasë dhe të krijojnë një frymë bashkëpunuese me studentët e tyre. Mund të postoni videot, fotot, dokumentet dhe burimet e tjera të rëndësishme për zgjidhjen e detyrave edukativo arsimore.

2. Twitter: Twitter ofron një mënyrë të shpejtë për të postuar informacione në kohë reale. Gjithashtu ndihmon nxënësit të ndjekin kurse të ndryshme dhe ofron informacion të përditësuar, duke eliminuar nevojën për kërkime të gjera.

3. Bloget: Bloget krijojnë mundësi për studentët që të shkruajnë dhe të shfaqin shkrimet e tyre në një shkallë të lartë.

4. YouTube: Me YouTube studentët kanë mundësi të krijojnë video të shkëlqyera rreth materialit të kurseve por edhe të shikojnë se si mund ta zgjedhin një detyrë të caktuar rreth kursit, pra Youtube u mundëson studentëve të shprehin kreativitetin e tyre lidhur me materialin e kursit.

5. Instagram: Instagrami mund të shfaqë punën e studentëve duke ofruar një vend për të shfaqur punën kreative të tyre.

Rrjetet sociale promovojnë punën midis nxënësve dhe mundësinë për të përmirësuar të nxënësit aktiv [7]. Megjithatë rrjetet sociale kanë ndikimet pozitive dhe negative të tyre.

Në vazhdim do ti listojmë disa prej tyre.

3.4 Ndikimet pozitive të rrjeteve sociale

Me anë të rrjeteve sociale studentët kontaktojnë më lehtë me njëri tjetrin, mund të punojnë në grupe edhe pse nuk gjenden në klasë.

Studentët të cilët kanë vështirësi për të shprehur mendimet e tyre mund të përfshihen në procesin mësimor përmes rrjeteve sociale bashkë me studentët tjerë dhe kjo u ndihmon në krijimin e vetëbesimit. Rrjetet sociale u ndihmojnë mësimdhënësve të bashkëpunojnë me studentët dhe të jenë në kontakt me prindërit e tyre për ti njoftuar në çdo kohë për rezultatet dhe progresin e fëmijëve të tyre. Rrjetet sociale gjithashtu sjellin lirinë që nxënësit e fitojnë dhe bashkëpunojnë jashtë kufijve institucionalë si dhe të fitojnë përvojë praktike. Rrjetet sociale kanë mjaft parametra të privatësisë dhe sigurisë.

3.5 Ndikimet negative të rrjeteve sociale

Rrjetet sociale kanë ndikuar shpeshherë në disponimin dhe vetëkontrollin e njerëzve, kjo ka ndikuar sidomos tek të rinjtë. Shpeshherë postime të ndryshme nga përdoruesit kanë krijuar një stres, frikë, pakënaqësi tek të tjerët.

Një efekt negativ që përmendëm më lartë dhe që është konstatuar nga studime të shumta është lënja pasdore e mësimave duke i shfrytëzuar faqet e internetit për argëtim në vend që të studiojnë ose të bashkëveprojnë me studentët e tjerë. Kjo shkakton humbjen e kohës dhe si rezultat ngecje në mësim. Pra studentët duhet ta kenë parasysh dhe ta vlerësojnë kohën dhe mos ti lënë anash studimet e tyre. Studentët që i përdorin rregullisht rrjetet sociale mund të humbasin aftësinë e tyre për t'u angazhuar në komunikimin ballë për ballë [7].

Duhet të kihet parasysh se rrjeti social krijon botën virtuale, që ndryshon shumë nga realiteti që na rrethon.

3.6 Roli i mësimdhënësit në rrjetet sociale

Padyshim që mësimdhënësi luan një rol mjaft të madh dhe bashkëpunues me studentëve duke i inkurajuar dhe motivuar ata rreth mësimave të tyre.

Mësuesi ka rol dytësor apo udhëzues derisa studentët kanë vetëkontrollin rreth mësimave të tyre dhe vendosin rregullat e procesit mësimor gjatë kursit.

Studentët në mënyrë aktive planifikojnë aktivitetet e tyre dhe marrin role të ndryshme brenda një grupi dhe kështu aktivizohen më shumë rreth zhvillimit të procesit mësimor.

Në përgjithësi, roli i mësuesit në SNS-të është definuar si i rëndësishëm dhe delikat [7]. Në praktikë, kjo krijon një klimë bashkëpunuese dhe të hapur duke shfrytëzuar përvojën pedagogjike për të krijuar struktura mbështetëse për mësim.

Është e dobishme për mësuesin: Të lejon që grupi të jetë dominues në mësimin e tyre. Të lejon nxënësit të marrin nën kontroll zhvillimin e mësimin dhe mënyrat e të punuarit së bashku. Të mban një vështrim të afërt në grup pa ndërhyrë, por i gatshëm për tu ndihmuar [7]

Sipas mendimit të Pearson, mënyra e institucioneve arsimore për të përfutur nga rrjetet sociale për nxitjen e zhvillimit profesional, zgjerimin e arritjes institucionale dhe rritjen e suksesit të studentëve është bërë revolucionare [8].

Në vazhdim do ta paraqesim një studim tjetër që është bërë në SHBA për rrjetet sociale.

Sipas këtij hulumtimi ka pasur rritje të vazhdueshme në numrin dhe përdorimin e rrjeteve sociale nga popullata e SHBA-së [8]. Ky studim shqyrton ndikimin e rrjeteve sociale në përdorimin personal, profesional dhe mësimor nga stafi i Universitetit.

Në këtë hulumtim është gjetur se stafi akademik është mjaft i vetëdijshëm rreth përdorimit të rrjeteve sociale në procesin mësimor dhe ata e vlerësonin shumë përfshirjen e rrjeteve sociale në mësim.

Qëllimi i këtij studimi ishte të kuptojë ndikimin e rrjeteve sociale në procesin e mësimdhënies, poashtu të vërtetoj se sa ka njohuri stafi akademik rreth rrjeteve sociale.

Hulumtuesit nxorën informacione rreth përdorimit të mediave sociale në fakultete dhe atë për qëllime personale dhe profesionale.

Nga ky hulumtim doli se stafi i fakulteteve kanë mjaft njohuri mbi faqet e mediave sociale.

Mbi 90% raportuan se kanë më shumë njohuri për rrjete të tilla si MySpace, Facebook, Twitter, YouTube dhe Blogs [8]. Ndërsa më pak i njohin rrjetet tjera siç janë Wikis, LinkedIn, etj [8].

Në këtë studim u konstatua edhe se universitetet që kanë një përvojë më të gjatë të mësimdhënies dhe operojnë më shumë se 20 vite kanë njohuri dhe i përdorin më shumë rrjetet sociale sesa ato universitete që kanë më pak përvojë si institucione arsimore.

Sipas këtij studimi ka një ndryshim të vogël tek njohurit rreth një rrjeti social: meshkujt kanë më shumë gjasa të kenë njohuri për LinkedIn sesa femrat. Të gjitha rrjetet tjera sociale nuk tregojnë dallime gjinore në nivelin e njohurisë [8].

Në këtë hulumtim gjithashtu u konstatua se Universitetet që në kuadër të tyre kanë programe online të ligjërimit përdorin më shumë mediat sociale sesa ato që nuk kanë programe online.

Raporti është 80% postojnë përmbajtje të ndryshme dhe 57% vizitojnë faqet e SNS-ve fakultet që kanë programe online, ndërsa tek ato që nuk kanë programe online raporti është 75% postojnë dhe 47 % vizitojnë SNS-të [8].

Ilustrimet e këtyre rezultateve janë paraqitur në figurat më poshtë.




Figura 4: Përdorimi i mediave sociale për mësim online dhe jo online [35]




Figura 5: Përdorimi i mediave sociale sipas faqeve të tyre

Sondazhi i këtij hulumtimi tregon se më shumë se 90% e fakultetit përdorin rrjetet sociale për qëllime profesionale ose në klasat e tyre ose të dyja [8].

Një total prej 78% e të gjitha raporteve të fakultetit përdorin të paktën një faqe të rrjeteve sociale në mbështetje të aktiviteteve të tyre profesionale. Duke përfshirë të gjitha nivelet e përdorimit, numri më i madh i përdoruesve del të jetë YouTube për përdorim profesional (jo të mësimdhënies) sesa çdo faqe tjetër i rrjeteve sociale [8].

Sipas hulumtimit [8] mënyra e përdorimit ndryshon tek SNS-të, për shembull Facebook përdoret më rrallë se YouTube (45% krahasuar me 58% për YouTube). Mbi një të katërtën e raportit të fakultetit përdorin bloget, LinkedIn, dhe Wikis. Dhe pak më shumë se 10% përmendin Twitter ose Flickr. Përdorimi profesional i SlideShare dhe Myspace është nën 10% [8].

Përdorimi ditor i Facebook-it, në 11%, tejkalon atë të faqeve të tjera të rrjeteve sociale, pasuar nga blogs (5% përdorim ditor), YouTube (4%) dhe Wikis (3%).

Mbi 40% e fakultetit i kanë caktuar studentët të lexojnë ose shikojnë rrjetet sociale si pjesë e detyrave të kurseve dhe 20% i kanë caktuar studentët të komentojnë ose të postojnë në faqet e mediave sociale. Në total, 80% e fakultetit raportojnë duke përdorur rrjetet sociale për disa aspekte të një kursi që po mësojnë [8]

Videoja në internet është deri më tani lloji më i zakonshëm i rrjeteve sociale të përdorura në klasë.

YouTube dhe Facebook - mbeten dy rrjetet më të mëdha për përdorim personal, dhe niveli i përgjithshëm i përdorimit për qëllime profesionale është shumë më i ulët sesa për përdorim personal [9].

Rezultate ndryshojnë kur vihet në pyetje nëse një edukator duhet të përdorë rrjetet sociale: sipas hulumtimit rreth 40% janë neutralë, 40% pajtohen dhe 20% nuk pajtohen [8].

Kur u pyetën rreth pengesave të mundshme për përdorimin e rrjeteve sociale, të anketuarit thonë se dy shqetësimet e tyre më të rëndësishme janë:

Privatësia dhe integriteti: 80% raportojnë se mungesa e integritetit është një pengesë për ata dhe mbi 70% thonë se shqetësimet e privatësisë dhe sigurisë duhet rikuperuar.

Pra rreziku i integritetit, privatësia, siguria por edhe humbja e kohës kur SNS-të nuk përdoren për qëllime edukative janë njëra nga arsytet që universiteti vë në dyshim për përdorimin e rrjeteve sociale në procesin mësimor [8].

Një studim tjetër në një Universitet në shtetin e Miçiganit jep informacion mbi përdorimin e teknologjisë në arsimin e lartë. Ky studim tregon mënyrat e mësimdhënies dhe mësimi për profesorët që ligjerojnë me programet online [9].

Interneti dhe rrjetet sociale në veçanti duket të jenë mjaftë të rëndësishme për studentët të cilët ndjekin programe online nëpër universitet të ndryshme nëpër botë derisa ata jetojnë nëpër vendet e tyre dhe shfrytëzojnë teknologjinë dhe mediat sociale për të ndjekur kurset e tyre.

Këta student ndërkombëtar përdorën më shumë Facebook për tu inkuadruar në mjediset mësimore, poashtu edhe për të krijuar lidhje shoqërore me studentë tjerë.

Një hulumtim tjetër na thotë: nxënësit që përdorin më shumë Facebook për shkëmbimin e të dhënave dhe ndjekjen e aktiviteteve marrin nota më të larta se ata që e përdorën atë vetëm për shoqërim [9].

Sipas anketës, studentët treguan se duke përdorur mediat sociale kanë përgatitur më mirë provimet e tyre, madje ata u kanë rekomanduar të gjithë studentëve të përdorin këto rrjete. Sipas tyre rrjetet sociale ndikuan pozitivisht në performancën akademike të tyre [9].

Një artikull tjetër na tregon gjetjet në Universitetin gjerman në Kajro të Egjiptit ku qëllimi kryesor ishte të gjej ndikimin e rrjeteve sociale në punën akademike të nxënësve [10].

Në këtë hulumtim nxënësit u anketuan për ndikimin e rrjeteve sociale në procesin mësimor dhe cilat faqe të SNS-ve ishin më të përshtatshme për ata. Nxënësit deklaruan se cilat platforma përdornin më së shumti, 41% përdornin Facebook dhe 32% përdorin Google. Platforma më e vogël që u përdor ishte SnapChat. Platformat e tjera ishin, Instagram 27% pastaj Twitter dhe YouTube ku niveli i tyre i përdorimit ishte më i vogël [10].

Gjithashtu u kërkua të përmendin nëse përdornin mediat sociale për të studiuar apo jo dhe si i përdorin mediat sociale për studim. Rreth 92% e të anketuarve deklaruan se përdorin internetin dhe mediat sociale për të studiuar.

Nxënësit deklaruan se rrjetet sociale i përdornin kryesisht për të zgjidh probleme të caktuara lidhur me kursin, duke vequr lëndën e Matematikës për të zgjidhur ekuacione të ndryshme. Sipas tyre këto rrjete i ndihmonin ata të jenë më të sukseshëm në mësimet e tyre.

Të anketuarve iu kërkua gjithashtu të tregonin numrin e orëve që ata shpenzojnë çdo ditë në mediat sociale dhe rezultatet ishin siq shihet edhe në figurën 6. Rreth 50% e të anketuarve shpenzojnë 1-3 orë në ditë duke studiuar.




Figura 6: Numri i orëve që shpenzojnë në media sociale brenda ditës [10]

Një studim tjetër në Universitetin e Edukimit në Ghana jep një rezultat tjetër për mediat sociale [11].

Studentët u pyetën se a kanë telefon celular dhe a kanë objekt interneti në telefonat e tyre. Nga të anketuarit, (93.4%) janë përgjigjur pozitivisht për posedimin e telefonave celular dhe 85% treguan se ata kishin objekt interneti në telefonat e tyre [11]. Një pyetje tjetër ishte për të gjetur nëse të anketuarit kishin njohuri për faqet e mediave sociale. Të gjithë të anketuarit 100% kishin njohuri për rrjetet sociale. Mund të konkludohet se shumica e të anketuarve kanë telefon celular dhe gjithashtu kanë njohuri për faqet e mediave sociale.

Madje studentët kishin edhe faqet e tyre të preferuara të mediave sociale. Facebook përfaqëson 66.4%, WhatsApp përfaqëson 19.9%, Twitter përfaqëson 6.2%, Skype me 3.3%, MySpace me 2.9% [11]. Hulumtimi tregon se Facebook është platforma më e preferuar e mediave sociale.

Sipas studiuesve mbi rrjetet sociale përdorimi i teknologjisë është një nga faktorët më të rëndësishëm që mund të ndikojë pozitivisht ose negativisht në punën e nxënësve [11].

Hulumtimi në Universitetin e Ghana-s na tregon se 74.2% treguan se përdorimi i mediave sociale nuk kishte përmirësuar punën akademike të studentëve, 19.9% thanë që mediat sociale ndikuan pozitivisht në performacën akademike ndërsa 5.7 % nuk u përgjigjën fare.

Sipas hulumtuesve të gjithë studentët kishin njohuri rreth mediave sociale dhe i përdornin mjaft, po vetëm për qëllime argëtimi por jo edhe për të studiuar, pra sipas tyre përdorimi i mediave sociale nuk ka ndikuar pozitivisht në performancën akademike të studentëve [11].

Pas shfletimit të artikujve lidhur me ndikimin e rrjeteve sociale në edukim është vërejtur se hulumtuesit kanë nxjerr rezultate përafërsisht të ngjajshme.

Sipas hulumtimit që u bë nga Palmer (2016) studentët kishin mendim pozitiv për mediat sociale në lidhje me edukimin. Sipas një hulumtimi tjetër me studentët e mjekësisë nga Sterling (2017) studentët poashtu deklaruan se përdorimi i medias sociale ndikon pozitivisht në procesin arsimor [2].

Sipas një hulumtimi në Arabinë Saudite studentët nuk kanë marr ndonjë trajnim në përdorimin e kompjuterëve apo TIK në përgjithësi, ku 2.80% kishin vetëm një trajnim të tillë, krahasuar me 26.32% të mësuesve, ku rezultati tregon se shkollat e mesme nuk u ofrojnë nxënësve ndonjë lloj trajnimi në përdorimin e kompjuterëve apo telefonave të mençur, qoftë për qëllime edukimi ose në përdorim të përgjithshëm [3]. Ndërsa sa i përket pyetjes për telefonat celular të mençur, tregon se të gjithë mësuesit (100%) kanë telefona të mençur dhe pothuajse 72.95% të studentëve. Pra, shumica e mësimeve dhe studentëve kanë qasje të lehtë në internet gjatë gjithë kohës, pra është edhe një mundësi e mirë që ti përdorin rrjetet sociale për qëllime edukative.

Sa i përket publikimit të ndonjë aktiviteti në YouTube, 7.2% e mësimeve janë përgjigjur po, krahasuar me vetëm 0.31% të studentëve.

Renditja e përdorimit të faqeve të mediave sociale për studentët nga më të lartat në më të ultat janë si më poshtë: WhatsApp 72.44%, Instagram 69.43%, Snapchat 52.41%, Twitter 15.96%, Skype 10.24% dhe Facebook 0.31%. Krahasuar me renditjen e përdorimit të aplikacioneve të mediave sociale për mësuesit nga më të lartat në më të ultat janë si më poshtë: WhatsApp 100%, Instagram 61.40%, Twitter 49.12%, Telegram 21.05%, Facebook 14.06%, Snapchat 7.02% , Skype 5.26%, Path 3.51%. Është e qartë se mësuesit dhe nxënësit e përdorin WhatsApp-in, respektivisht 100% dhe 72.44%, si një aplikacion kryesor i mediave sociale në kontaktet e tyre me të tjerët, pastaj i dyti është Instagram me 69.43% të nxënësve dhe 61.40% për mësimeve [3].

Nga hulumtimi që është bërë në shkollat e mesme saudite, rezultatet treguan se pothuajse të gjithë mësime dhe nxënësit kishin telefon celular të mençur, dhe kjo është një mundësi e lehtë dhe praktike që ata ti përdorin rrjetet sociale nga telefonat e tyre.

Poashtu rezultatet na treguan se rreth 95 % e mësuesve kishin qasje në internet, ndërsa 85% e nxënësve kishin qasje në internet.

Sa i përket aplikacioneve të medias sociale, është e qartë se mësuesit dhe nxënësit e përdorin WhatsApp-in si një mjet kryesor, me 100% për mësuesit dhe pothuajse 73% për studentët.

Një shqetësim është vërejtur tek hulumtimi ku mësuesit dhe nxënësit deklaruan rreth kostos që duhet të paguanin.

Nxënësit dhe mësime dhe treguan gatishmëri që ti përdornin rrjetet sociale dhe kishin mendime pozitive rreth ndikimit të mediave në procesin mësimor por çuditërisht ata nuk i praktikonin shumë për të studiuar.

Poashtu infrastruktura dhe teknologjia ishte në dispozicion të tyre dhe ishte një mundësi e mirë që ata të rrisin nivelin e vetëdijes rreth përdorimit të rrjeteve sociale për të rritur edhe njohuritë edukative arsimore.

Nga ky hulumtim studiuesit përfunduan se mësuesit dhe nxënësit kanë nevojë për trajnime në mënyrë që ata ta vlerësojnë përdorimin e mediave sociale në edukim.

Ky është hapi i parë dhe shumë i rëndësishëm për zbatimin e plotë të mediave sociale në edukim [3].

3.7 Përfundimi dhe rekomandimet e autorëve

Siç deklarua edhe më herët se zhvillimi i teknologjisë solli edhe zhvillimin e rrjeteve të ndryshme sociale dhe përdorimin e tyre në masë të madhe nga të gjitha moshat. Në këtë punim janë analizuar një sërë artikujsh që lidhen me përdorimin e rrjeteve sociale dhe që për qëllim kryesor ishte ndikimi i rrjeteve sociale në edukim.

Sipas rezultateve të këtyre artikujve mund të konstatohet se në përgjithësi ishin rezultate pozitive ku hulumtuesit treguan se rrjetet sociale u japin mundësi studentëve të bashkëpunojnë mes vete, të komunikojnë, të argëtohen dhe po në të njëjtën kohë edhe të ndjekin studimet e tyre.

Sipas studimit të disa artikujve [8 dhe 9], është konstatuar se mediat sociale nuk ndikojnë negativisht në performancën akademike të studentëve në asnjë mënyrë, sepse edhe pse shpenzojnë kohë në mediat sociale, ata ende arrijnë të gjejnë kohë për të studiuar dhe për të rritur njohuritë e tyre.

Në përgjithësi hulumtimet tregojnë se pothuajse të gjithë duke përfshirë edhe studentët edhe mësime dhe treguan se kishin telefona të mençur dhe ishin të pajisur me internet, poashtu kishin mjaft njohuri për rrjetet sociale.

Me përjashtim të një hulumtimi në Ghana ku të anketuarit shprehën mendime negative rreth përdorimit të mediave sociale në edukim, ata shprehën se këto rrjete sociale i përdornin më shumë për tu shoqëruar dhe komunikuar me miqtë e tyre.

Studentët deklaruan se rrjetet sociale u mundësuan atyre të krijojnë miq të rinjë, të marrin informacione të reja, të bashkëpunojnë rreth kurseve të tyre përmes grupeve të krijuara dhe në përgjithësi ata thjeshtë ishin më të integruar.

Me anë të rrjeteve sociale studentët ishin më të motivuar dhe mësimet u bënë më atraktive, ata ndanin informacione të reja mes vete, mund të shkëmbejnë idetë e tyre më lirshëm, thjeshtë ata krijuan një vetbesim më të madh duke u inkuadruar rreth aktiviteteve edukative. Kjo ishte një mundësi e shkëlqyer pikërisht për ata studentë që kishin ngurruar të shprehnin mendimet e tyre dhe nuk ishin përshtatur shumë me mësimin tradicional nëpër klasa.

Sipas hulumtimeve pothuajse shumica e vendeve në mbarë botën tashmë kanë dëgjuar për mediat sociale apo edhe i praktikojnë ato në masë të madhe, në të gjitha aspektet por rëndësia e veçantë mbetet që këto rrjete ti përdorin sa më shumë në edukim.

Bazuar në gjetjet, hulumtuesit dhanë disa rekomandime:

Nxënësit që posedojnë telefona të mençur dhe që janë të pajisur me internet duhet të inkurajohen ta përdorin atë për të plotësuar kërkimet e tyre rreth studimeve në vend të bisedës së zakonshme me miqtë gjatë gjithë kohës. Nxënësit duhet të këshillohen që të kufizojnë kohën që shpenzojnë në faqet e mediave sociale dhe t'i inkurajojnë ata që ti zëvendësojnë ato orë për libra akademike për të përmirësuar njohuritë e tyre. Meqenëse disa studime konfirmuan se përdorimi i mediave sociale ka ndikuar negativisht në performancën akademike të nxënësve, ekziston nevoja për këshillimin e nxënësve që ti përdorin rrjetet sociale në mënyrën e duhur.

Gjithashtu rekomandohet që studentët të këshillohen për rrezikun e varësisë nga faqet e rrjeteve sociale. Ata duhet të shfletojnë faqet që mund ti rrisin vlerat në punën e tyre akademike dhe kërkime shkencore por jo ti keqpërdorin ato për qëllime tjera.

4. Ndikimi i përdorimit të rrjeteve sociale tek nxënësit e shkollave të mesme.

Studim rasti - shkollat e mesme në Ferizaj

Ky hulumtim është bërë me qëllim që të marrim informacion rreth përdorimit të rrjeteve sociale nëpër shkolla të mesme se për çfarë i përdorin ato dhe a kanë ndikim në performancën e nxënësve. Hulumtimi është bërë në tri shkolla të mesme në Ferizaj: shkolla e mesme ekonomike “Faik Konica”, shkolla e mesme e mjekësisë “Elena Gjika” dhe shkolla e mesme teknike “Pjetër Bogdani”.

Hulumtimi është bërë me anë të një pyetësoi i cili përmban 18 pyetje të ndryshme dhe gjithsej pjesëmarrës ishin 200 nxënës. Po ashtu një pyetësor tjetër ka qenë i dedikuar për mësimdhënës, ku morën pjesë 50 mësimdhënës nga të njejtat shkolla.

Në vazhdim janë paraqitur rezultatet e përgjigjeve të marrura nga pyetësorët.

4.1 Rezultatet nga hulumtimi i bërë me nxënës

Në figurën 7 është paraqitur shpërndarja e të anketuarve sipas gjinisë nga e cila shihet se nga të gjithë nxënësit e anketuar 53% ishin të gjinisë mashkullore ndërsa 47% ishin të gjinisë femrore.




Figura 7: Shpërndarja e të anketuarve sipas gjinisë

Nxënësit ishin të moshave 15 vjeç, 16 vjeç, 17 vjeç dhe 18 vjeç ndërsa shpërndarja e nxënësve sipas moshës është paraqitur në figurën 8.




Figura 8: Shpërndarja e të anketuarve sipas moshës




Figura 9: Shpërndarja sipas posedimit të telefonave të mençur

Nga gjithsej nxënësit e anketuar 93.5% u përgjigjën se kanë telefona të mençur (Smart Phone) ndërsa vetëm 6.5% nuk kishin telefona të mençur siç shihet në figurën 9. Bazuar në këto rezultate mund të themi se përdorimi i telefonave të mençur nga moshat e reja është mjaftë i lartë dhe kjo sigurisht vërejtje pas avansimit të shpejtë të teknologjisë.

Në figurën 10 është paraqitur shpërndarja e të anketuarve se sa janë të informuar për rrjetet sociale nga e cila shihet që një përqindje e lartë kanë ndëgjuar dhe kanë informata për rrjetet

sociale ndërsa vetëm 2.5% janë deklaruar se nuk kanë informata për rrjetet sociale. Nga kjo mund të përfundojmë se përdorimi i rrjeteve sociale nga të rinjtë konkretisht nga nxënësit e shkollave të mesme është mjaftë i lartë.




Figura 10: Shpërndarja sipas informatave për rrjetet sociale




Figura 11: Përgjigjja e nxënësve se cilin rrjet social e përdorin më shumë

Sa i përket pyetjes se cilin nga rrjetet sociale e përdorin më shumë, shumica e përgjigjeve kanë qenë më një apo më shumë zgjidhje ku një nxënës përdor dy e më shumë rrjete sociale. Sipas analizave të hulumtimit rrjeti social i cili përdoret më së shumti nga nxënësit është Instagram pas

të cilit rendit Youtube, Facebook, etj. Nga figura shihet që nga të gjithë të anketuarit 83% prej tyre e përdorin më së shumti rrjetin social Instagram.




Figura 12: Koha e shpenzuar në rrjetet sociale nga nxënësit

Pasi që një numër mjaftë i madh i nxënësve përdorin rrjetet sociale është mjaft e rëndësishme të analizohet se sa kohë në ditë ata kalojnë në rrjetet sociale e cila është edhe sfida kryesore e përdorimit të rrjeteve sociale. Nga të dhënat e analizuara nga pyetësorët siç edhe shihet nga figura 12 vërehet që 29.80% e anketuarve i përdorin rrjetet sociale 3 orë e më shumë në ditë dhe një numër i vogël është përgjigjur se ata përdorin rrjetet sociale vetëm 2-3 orë në ditë.

Në mënyrë që të analizojmë ndikimin e rrjeteve sociale për të mësuar, nxënësit janë pyetur se sa kohë shpenzojnë ata për të mësuar që sipas të dhënave të paraqitura në figurën 13 shihet se vetëm 5% nga të anketuarit janë përgjigjur që shpenzojnë më shumë se 3 orë për të mësuar ndërsa 52% nga ta janë përgjigjur që shpenzojnë deri 30 minuta kohë në rrjetet sociale për të mësuar. Duke parë përgjigjet e nxënësve shihet se ata i përdorin rrjetet sociale edhe për të mësuar por jo në mënyrë të kënaqëshme.




Figura 13: Koha e shpenzuar në rrjetet sociale për mësim




Figura 14: Përdorimi i rrjeteve sociale për komunikim

Nga përgjigjet e nxënësve lidhur me këtë pyetje shihet që nxënësit pjesën më të madhe të kohës e kalojnë duke u argëtuar dhe komunikuar me miqtë e tyre pasi që siç shihet nga figura 14 nga të anketuarit 47.50% janë përgjigjur se gjithmonë rrjetet sociale i përdorin për të komunikuar me miqtë. Rezultati i kësaj pyetje na kthen tek hipoteza që e kemi parashtruar në fillim se rrjetet sociale përdoren më shumë për argëtim sesa për njohuri akademike.




Figura 15: Përdorimi i rrjeteve sociale për foto dhe video

Siç shihet nga figura 15 që rrjetet sociale për qëllime multimediale përdoren mjaftë nga ana e nxënësve. Duke u bazuar nga përgjigjet e tyre shihet që nga të gjithë nxënësit e anketuar 35.50% janë përgjigjur që ndonjëherë i përdorin për qëllime multimediale ndërsa 16% e tyre kanë thënë se gjithmonë i përdorin rrjetet sociale për qëllime multimediale. Po ashtu një përqindje e konsiderueshme rreth 15.50% janë përgjigjur që zakonisht rrjetet sociale i përdorin për qëllime multimediale.

Sa i përket pyetjes se a i përdorin për të mësuar rrjetet sociale nga gjithsej të anketuarit 43.22% e tyre janë përgjigjur se ndonjëherë përdorin rrjetet sociale për të mësuar ndërsa 14.07% e tyre kanë thënë që gjithmonë i përdorin rrjetet sociale për të mësuar. Nga kjo mund të përfundojmë se rrjetet sociale nga nxënësit e shkollave të mesme përdoren edhe për të mësuar. Këto rezultate janë paraqitur grafikisht më anë të figurës 16.




Figura 16: Përdorimi i rrjeteve sociale për të mësuar

Një pyetje tjetër ishte pyetja se a janë të informuar nxënësit apo kanë ndjekur ndonjë trajnim rreth përdorimit të rrjeteve sociale për mësim.




Figura 17: Rezultatet rreth trajnimeve për rrjetet sociale

Në figurën 17 është treguar shpërndarja e të anketuarve nëse ata i kanë mësuar rrjetet sociale nëpër trajnime të ndryshme apo nga persona të tjerë, ku siç shihet rreth 67.5% e të anketuarve nuk kanë ndjekur trajnime për rrjetet sociale ndërsa 32.5% nga ta kanë mësuar përdorimin e rrjeteve sociale nga trajnime të ndryshme apo nga persona të tjerë të cilët përdornin rrjetet

sociale. Nxënësit gjithashtu janë deklaruar se për të mësuar përdorin më së shumti Google+, pastaj Youtube etj.




Figura 18: Komunikimi i mësime dhënëse dhe nxënësve përmes rrjeteve sociale

Sa i përket komunikimit të mësime dhënëse dhe nxënësve në rrjetet sociale kemi një shpërndarje afërsisht të barabartë e cila grafikisht është paraqitur në figurën 18. Siç shihet nga figura 46% e të anketuarve janë përgjigjur që komunikojnë përmes rrjeteve sociale, respektivisht 46% me 54% pra çka kuptojmë se këtu varet nga iniciativa e mësime dhënësit për të komunikuar me nxënësit nëpërmjet rrjeteve sociale.




Figura 19: Suksesi i nxënësve në mësim nga përdorimi i SNS-ve

Sa i përket ndikimit të rrjeteve sociale në progresin e nxënësve në mësim nga të gjithë nxënësit e anketuar 81.5% e tyre mendojnë se rrjetet sociale ju kanë ndihmuar të marrin më shumë informata për mësim, 11% mendojnë se rrjetet sociale nuk ju kanë ndihmuar për të arritur një sukses më të mirë, ndërsa 7.5% e tyre nuk kanë dhënë përgjigje.

Disa nga përgjigjet e të anketuarve ishin që rrjetet sociale ju kanë ndihmuar në disa lëndë të caktuara ku kanë pasur nevojë ti zgjerojnë njohuritë e tyre. Po ashtu sipas nxënësve kur ata përdorin rrjetet sociale për mësim bëjnë edhe zgjidhjen e problemit apo detyrave të caktuara si dhe marrin njohuri të reja.

Nuk ka metodë të mjaftueshme për të vërtetuar ndershmërinë dhe vërtetësinë e aktiviteteve të rrjetëzimit social të përdoruesve. Synimet e përdorimit të mediave sociale përfshijnë transparencën e komunikimeve dhe postimeve të aktiviteteve të tjera përmes SNS-ve.

Sa i përket kësaj qështje nxënësit janë pyetur nëse kanë njohuri për abuzimet nëpër rrjetet sociale dhe ngacmimet elektronike.




Figura 20: Përgjigjet për abuzimet dhe ngacmimet nëpër rrjete sociale

Sa i përket njohurive për abuzimet në rrjetet sociale 51% janë përgjigjur që janë të informuar për abuzimet me rrjetet sociale ndërsa 32.5 % nuk kishin informata të tilla, dhe 16.5% nuk kanë dhënë përgjigje. Po ashtu disa nga të anketuarit kanë treguar disa raste konkrete të abuzimit në rrjetet sociale për të cilat kanë ndëgjuar siç janë:

- Kemi dëgjuar që ka shumë profile të rreme dhe me këto profile abuzojnë me rrjetet sociale personat e papërgjegjshëm.
- Rasti i gruas rome e cila u sulmua fizikisht, përshkak të keqpërdorimit të rrjeteve sociale nga portalet e ndryshme.

- Po kam dëgjuar, një shoqes time i kanë shpërndarë një video dhe e kanë përqeshur me atë video, ishte njëra nga përgjigjet.

Në figurën 21 janë paraqitur rezultatet nëse nxënësit i neglizhojnë mësimet për të kaluar kohë në internet. Siç shihet nga figura një përqindje e konsiderueshme e nxënësve (rreth 52.50%) janë përgjigjur që disa herë i neglizhojnë mësimet për të kaluar kohën në internet.

Duke ju referuar këtij fakti mund të themi që është shqetësuese kur nxënësit humbin kohën duke përdorur rrjetet sociale vetëm për argëtim dhe jo për mësim.




Figura 21: Sa neglizhohet mësimi duke kaluar kohë në internet




Figura 22: Njoftimi i prindërve për shpenzimin e kohës në internet

Nga të dhënat në figurën 22 shihet se prindërit janë në dijeni për fëmijët e tyre se sa kohë ata shpenzojnë nëpër SNS-të, nëse ata janë prezent kur fëmijët përdorin telefonat e tyre.

Meqenëse përdorimi i rrjeteve sociale nga nxënësit e shkollave të mesme është mjaftë i lartë dhe duke pasur parasysh faktin që përdorimi i tyre bëhet kryesisht për komunikim dhe argëtim nxënësit janë pyetur nëse ata mendojnë se përdorimi i tyre ka ndikuar në rezultate më të dobëta në mësim.



Figura 23: Ndikimi i rrjeteve sociale në notat e nxënësve

Nga gjithsej të anketuarit 61% kanë menduar që rrjetet sociale ndikojnë negativisht në suksesin e tyre ndërsa 39% nuk mendojnë se rrjetet sociale ndikojnë në suksesin e tyre në mësim. Pra sipas tyre kur kalojnë shumë kohë në internet dhe humbin kohë pa nevojë vërehet edhe një ngecje në mësim dhe humbja e kohës ka ndikim edhe tek notat e tyre.



Figura 24: Siguria në rrjetet sociale

Sa i përketë sigurisë në rrjetet sociale 7% janë deklaruar se ndihen të sigurtë në përdorimin e rrjeteve sociale dhe ju besojnë të gjitha përmbajtjeve që shohin në faqet e rrjeteve sociale. Siç shihet nga figura 93% e nxënësve nuk ndihen të sigurtë në përdorimin e rrjeteve sociale dhe gjithashtu nuk besojnë gjithçka që shohin në faqet e rrjeteve sociale. Nga këto rezultate mund të themi se nxënësit janë të vetëdijësuar për sigurinë e të dhënave në rrjetet sociale dhe konfidencialitetin e tyre.

Që nga fillimi i përdorimit të rrjeteve sociale, cilësia e bisedave ka rënë, njerëzit po shpenzojnë aq shumë kohë në internet sa që ata nuk e kuptojnë gjithmonë ndjenjën, emocionin ose karakterin e personit me të cilin po flasim. Për fat të keq, nganjëherë miqtë përdorin telefonat e tyre aq shumë sa që është e vështirë të kesh një bisedë të vërtetë me ta edhe nëse je ballë për ballë me ta. Duke u bazuar në këtë fakt nxënësit janë pyetur nëse ata mendojnë se përdorimi i tepërt i rrjeteve sociale i ka vënë në një situatë ku kanë vështirësi në komunikimin ballë për ballë. Rezultatet nga anketa se a ndikojnë rrjetet sociale në komunikimin ballë për ballë janë paraqitur në figurën e 25. Siç shihet nga figura, 49% e tyre mendojnë se përdorimi i rrjeteve sociale asnjëherë nuk u ka sjellur vështirësi në komunikimin ballë për ballë, megjithatë 7% e tyre kanë thënë se shumë herë përdorimi i rrjeteve sociale ju ka krijuar vështirësi ose ka dëmtuar komunikimin e tyre ballë për ballë me persona tjerë.




Figura 25: Përdorimi i rrjeteve sociale-vështirësi në komunikimin ballë për ballë

4.1.1 Konkluzione nga anketa me nxënës

Në këtë anketë që u realizua me nxënës të shkollave të mesme ku pothuajse të gjithë nxënësit janë përgjigjur në pyetjet që janë parashtruar për hulumtim dhe rezultatet na tregojnë që janë vërtetuar hipotezat që janë parashtruar, po ashtu edhe disa faktorë negativ që lidhen me përdorimin e rrjeteve sociale nga nxënësit.

Duke shikuar anën pozitive dhe rëndësinë e rrjeteve sociale në mësim nëpër shumë universitete të botës që kanë shpjeguar autorë të ndryshëm ne kemi krijuar përshtypjen se rrjetet sociale luajnë një rol të rëndësishëm në mësimnxënie.

Rezultate nga anketa japin një realitet tjetër për dallim nga shumica e shkollave dhe universiteteve nëpër botë ku rrjetet sociale kanë patur një ndikim pozitiv në mësimnxënie dhe mësimdhënie poashtu.

Duke u bazuar në përgjigjet e nxënësve në pyetjen e 14 se sa i neglizhojnë mësimet nxënësit duke kaluar kohën në internet pjesa dërmuese e nxënësve apo më mirë të themi 52.50 % janë përgjigjur se disa herë i neglizhojnë mësimet, rreth 19% shpeshherë dhe 4% shumëherë i neglizhojnë mësimet. Ky rezultat na tregon se rreth 76% e nxënësve për të kaluar kohën në internet apo në rrjetet sociale neglizhojnë edhe mësimet e tyre.

Gjithashtu edhe tek pyetja 16 në të cilën nxënësit pyeten se a kanë qenë notat e tyre më të dobëta kur ata kanë humbur pjesën më të madhe të kohës në internet, rezultatet tregojnë se 69% e nxënësve kanë thënë se kanë pasur nota më të dobëta dhe 39% e nxënësve kanë deklaruar se nuk ka ndikuar në notat e tyre.

Këto rezultate na tregojnë se përdorimi i rrjeteve sociale dhe internetit në përgjithësi nga nxënësit kanë ndikuar negativisht në procesin mësimor duke patur parasysh se ata i kanë përdorur rrjetet sociale për argëtim dhe kanë humbur kohën duke i neglizhuar edhe mësimet e tyre.

Ky konstatim na lidhet direkt edhe me hipotezën tjetër që është parashtruar se nxënësit i përdorin rrjetet sociale më shumë për argëtim sesa për të fituar njohuri të reja akademike.

Duke parë rezultatet në pyetjen 5 dhe 6 ku pyeten nxënësit se sa kohë shpenzojnë për të mësuar në rrjetet sociale dhe për çka i përdorin më shumë ata rrjetet sociale na tregojnë se një pjesë e vogël e nxënësve respektivisht 6 % shpenzojnë 2-3 orë për të mësuar dhe 5% e tyre 3 orë e më shumë për të mësuar ndërsa pjesa më e madhe nxënësve kalojnë vetëm 10-30 minuta për të mësuar.

Ata janë përgjigjur se kohën në rrjetet sociale e kalojnë për të biseduar me miqtë e tyre, për të postuar foto dhe video dhe në përgjithësi vetëm për argëtim.

Me këtë realitet jo të këndshëm, ndoshta edhe shqetësues janë listuar disa faktorë negativ që lidhen me përdorimin e SNS-ve, siq janë: mendimi kritik, humbja e kohës, largimi nga bota reale, shpërqëndrimi etj.

Lidhur me këta faktorë janë parashtruar pyetje edhe për nxënësit edhe për mësimdhënësit, dhe çka mendojnë mësimdhënësit për nxënësit e tyre.

Rreth 93 % (pyetja 17) të nxënësve kanë thënë se nuk besojnë gjithçka që shohin në rrjetet sociale dhe 49% (pyetja 18) janë deklaruar se nuk kanë vështirësi në komunikimin ballë për ballë.

Përsa i përket përgjigjes së mësimdhënësit rreth këtyre pyetjeve, mësimdhënësit janë deklaruar se rrjetet sociale ndikojnë pozitivisht tek nxënësit dhe kështu kanë menduar rreth 63.33 %, ndërsa a kanë vështirësi në komunikim ballë për ballë rreth 56 % të mësimdhënësit kanë thënë Po, ndërsa 44 % mendojnë se nuk kanë vështirësi në komunikimin ballë për ballë.

4.2 Rezultatet nga anketa me mësimdhënës

Një tjetër pyetësor ka qenë i dedikuar për mësimdhënës, i cili përmban pyetje se si dhe për çfarë i përdorin mësimdhënësit rrjetet sociale, sa ka ndikim në mësim përdorimi i rrjeteve sociale nga ana e nxënësve dhe cila është mënyra e duhur e përdorimit të SNS-ve sipas mësimdhënësve.

Në hulumtim morën pjesë gjithsej 50 mësimdhënës të të dy gjinive dhe moshave të ndryshme e cila ishte nga 24 vjet deri në 61 vjet. Hulumtimi është bërë në Qershor 2019.

Në vazhdim janë paraqitur rezultatet e anketës sipas përgjigjeve të marra nga anketa me mësimdhënës.

Në figurën 26 është paraqitur shpërndarja e mësimdhënësve të anketuar sipas gjinisë nga e cila shihet se 66% ishin femra ndërsa 34% ishin meshkuj.




Figura 26: Shpërndarja sipas gjinisë

Sa i përketë posedimit të telefonave të mençur nga ana e mësimdhënësve nga përgjigjet e marra shumica e tyre përdorin telefona të mençur. Këto të dhëna janë paraqitur në figurën 27 nga e cila shihet që 92% përdorin telefona të mençur ndërsa vetëm 8% e tyre nuk posedojnë telefona të mençur.



Figura 27: Posedimi i telefonave të mençur nga mësimdhënësit

Sa i përket informatave për rrjetet sociale nga përgjigjet e mësimdhënësve shihet se në përgjithësi ata kanë dëgjuar për rrjetet sociale dhe kanë njohuri për SNS-të. Sipas rezultateve të marra nga pyetësorët të cilët janë paraqitur në figurën 28 shihet që 96% kanë njohuri për përdorimin e rrjeteve sociale.




Figura 28: Njohuritë rreth rrjeteve sociale nga mësimdhënësit

Në këtë pyetje kishin mundësi që të përzgjedhnin një e më shumë rrjete sociale, dhe mësimdhënësit kanë renditur të parin Facebook me një përqindje të përdorimit rreth 92%, pas tij është renditur Google+ me rreth 54%, Youtube 40% etj.




Figura 29: Përdorimi i rrjeteve sociale nga mësimdhënësit

Edhe në këtë pyetje mësimdhënësit kishin mundësi të një e më tepër opzione, dhe përgjigjet janë paraqitur në figurën 30. Siç shihet nga figura rrjetet sociale nga ana e mësimdhënësve përdoren më së shumti për të biseduar me miqtë, e pastaj edhe për qëllime të tjera.




Figura 30: Arsyeja e përdorimit të rrjeteve sociale nga mësimdhënësit




Figura 31: Inkurajimi i nxënësve nga mësime dhënësit

Duke parë rezultatet e anketës kuptuam se pjesa dërmuese e nxënësve dhe mësime dhënësit përdorin rrjetet sociale për qëllime nga më të ndryshmet. Ne në anketë shtruan edhe pyetjen se sa i inkurajojnë mësime dhënësit nxënësit e tyre për përdorimin e rrjeteve sociale për mësim, dhe përgjigjet e tyre duket të jenë mbresëlënëse siç shihet në figurën 31, ku 40% e tyre i inkurajojnë gjithmonë, 54% disaherë dhe 6% asnjëherë.

Përdorimi i rrjeteve sociale nga ana e mësime dhënësit gjatë orës mësimore për çështje edukativo-arsimore mund të lehtësojë punën e mësime dhënësit dhe po ashtu të ketë ndikim tek nxënësit duke e bërë orën më argëtuese duke i'u larguar metodave tradicionale. Për të analizuar këtë, mësime dhënësit janë pyetur nëse mendojnë që rrjetet sociale lehtësojnë punën e tyre dhe në këtë pyetje 96% e tyre mendojnë që përdorimi i rrjeteve sociale lehtëson punën e tyre dhe 4% mendojnë që nuk ndikon në punën e tyre. Rezultatet e kësaj pyetje janë paraqitur në figurën 32.




Figura 32: Përdorimi i SNS-ve lehtëson punën e mësimeve




Figura 33: Ndikimi i SNS-ve në suksesin e nxënësve

Për sa i përket pyetjes se si ndikojnë rrjetet sociale tek nxënësit 64.0% e mësimeve mendojnë se përdorimi i tyre ndikon pozitivisht në suksesin e nxënësve, 26.0% mendojnë që ndikojnë negativisht dhe 10.0% mendojnë që përdorimi i rrjeteve sociale nuk ndikon fare në suksesin e nxënësve.

Meqenëse përdorimi i rrjeteve sociale është rritur dukshëm kohëve të fundit tek nxënësit, vërehet një mangësi në komunikimin ballë për ballë. Mësimdhënësit janë pyetur nëse mendojnë që përdorimi i rrjeteve sociale vështirëson të shprehurit dhe komunikimin dhe ata kanë ndarë mendime të ndryshme për këtë qështje. Rezultatet e tyre janë paraqitur në figurën 34. Nga figura shihet që 56.0 % mendojnë se nxënësit kanë vështirësi në komunikimin ballë për ballë dhe 44.0% prej tyre mendojnë se nxënësit nuk e kanë këtë problem edhe nëse kalojnë shumë kohë në rrjetet sociale.




Figura 34: Përdorimi i tepërt i SNS-ve vështirëson të shprehurit dhe komunikimin

9. Çka ju sugjeroni ju nxënësve, cila është mënyra e duhur për përdorimin e rrjeteve sociale?

Për sa i përket kësaj pyetje të gjithë mësimdhënësit kanë dhënë përgjigjet e tyre. Në vazhdim do ti paraqesim disa nga përgjigjet e tyre:

- Përdorimi për qëllime mësimore.
- Të përdoret për qëllime pozitive, për mësim elektronik, e-learning etj
- Nxënësve ju sugjeroj ti përdorin rrjetet sociale për mësim, dhe për qëllime të mira.
- Ta përdorin me orar të caktuar, kur nuk ndikon negativisht në suksesin e tyre.

4.2.1 Konkluzione nga anketa me mësimdhënëës

Për sa i përket anketës me mësimdhënëës edhe ata janë deklaruar se kanë njohuri mjaft për rrjetet sociale dhe i përdorin mjaft shumë rrjetet sociale.

Tani me rëndësi është të diskutohet se cili është roli i rrjeteve sociale në mes nxënësve dhe mësimdhënëësve dhe sa i përdorin ata për të komunikuar mes veti rreth procesit mësimor.

Pavarësisht se mësime dhënësit kanë deklaruar se kanë inkurajuar nxënësit të përdorin rrjetet sociale për mësim, nxënësit kanë dhënë tjetër përgjigje ku rreth 68% të tyre kanë thënë që nuk janë informuar apo nuk kanë mbajtur ndonjë trajnim që rrjetet sociale të përdorin për mësim, pra nga rezultati i anketës dhe përgjigjet e të dyja palëve kuptojmë që rrjetet sociale ata i përdorin për argëtim, për të biseduar me miq, për të ndarë informacione, për të postuar foto dhe video të ndryshme dhe më rrallë për gjërat që lidhen me procesin mësimor.

Pra duke parë këtë realitet unë besoj që është e nevojshme që të dyja palët edhe mësime dhënësit edhe nxënësit të inkurajohen apo edhe të trajnohen që rrjetet sociale të përdorin më shumë rreth procesit mësimor dhe kurseve që ata ndjekin, respektivisht kurseve që ata ligjërojnë.

Përfundimi

Interneti në ditët e sotme drejtohet nga aktivitetet e përdoruesve të tij, për dallim nga interneti i dikurshëm ku përdoruesit shkarkonin të dhënat, informacionet dhe ishte një sistem i transmetimit të njëanshëm.

Njerëzit sot e kalojnë pjesën më të madhe të kohës në kompjuter, në lojra të ndryshme, telefonat celularë, dhe në përgjithësi shfletojnë gjithë përmbajtjen që ofron interneti dhe bota dixhitale. Sot studentët kanë tjetër organizim shoqëror dhe atë e bëjnë duke shfrytëzuar internetin. Mësimi tradicional ka të bëjë më shumë me të mësuarit pasiv të një përmbajtje, ndërsa sot procesi mësimor është bërë më interaktiv falë teknologjisë së zhvilluar.

Njerëzit sot janë të përfshirë apo janë lidhur ngushtë me internetin në çdo aspekt jetësor.

Studime të shumta kanë treguar përfitimet e bashkëveprimit shoqëror duke shfrytëzuar internetin në procesin mësimor. Aspektet pozitive të ndërveprimit në internet me mësuesit dhe studentët përfshijnë marrjen e njohurive të reja, aftësi për të marrë reagime nga mësuesit dhe studentët dhe një mundësi shumë e mirë për punën ekipore. Duke shprehur mendimet e tyre, duke diskutuar dhe sfiduar idetë e të tjerëve, studentët punojnë së bashku në grup dhe bëjnë zgjidhje për një problem të caktuar, studentët zhvillojnë aftësi të të menduarit kritik, si dhe aftësi të vetëreflektimit dhe bashkë-ndërtimit të njohurive.

Pavarësisht se brenda përdoruesve të rrjeteve sociale ka kultura të ndryshme, parimet e mediave sociale mbeten të njëjta. Faqet e mediave sociale lejojnë përdoruesit të bisedojnë dhe bashkëveprojnë me njëri-tjetrin, për të krijuar, modifikuar dhe shkëmbyer informacione të ndryshme, përmbajtje audio dhe përmbajtje të ndryshme ekzistuese.

Karakteristikë e të gjitha këtyre mediave sociale është ajo e socializimit masiv duke shfrytëzuar bashkëveprimin e komuniteteve online të përdoruesve. Media sociale ka të bëjë me bashkëpunimin, rrjetëzimin, shkëmbimin dhe gjenerimin e njohurive dhe përmbajtjeve, dhe të gjitha këto karakteristika kanë një vlerë të madhe e veçanërisht në pjesën edukativo arsimore.

Media sociale luan një rol të rëndësishëm në jetën e çdo studenti, është më e lehtë dhe e përshtatshme për të hyrë në informacion, siguruar informacion dhe komunikuar përmes mediave sociale. Mësuesit dhe studentët janë të lidhur me njëri-tjetrin dhe mund të përdorin mirë këto platforma për punën e tyre akademike.

Mësimdhënësit po zgjerojnë përdorimin e mediave sociale për të bërë ligjërrata të drejtpërdrejta, ofrojnë mbështetje jashtë orarit për studentët, apo edhe debate studentore. Ky lloj i përdorimit të mediave sociale është shumë i rëndësishëm, por nëse mësuesit duan të ecin me hapat e ndryshimit të teknologjisë, ata duhet të jenë të hapur për ta eksploruar atë dhe ta përdorin në mënyrën e duhur.

Një nga arsyet që mësime dhënësit i përdorin mediat sociale në klasa është se ata i tregojnë aftësitë e tyre profesionale përmes mediave sociale. Jo vetëm që ata janë në gjendje ta bëjnë punën e tyre më me lehtësi, por gjithashtu po e tregojnë veten profesionalisht. Faqet në Facebook, në Twitter, faqet e ndryshme të blogut dhe kanalet në YouTube janë shembujt ku mund të shihni profesorët që shkëlqejnë me punën e tyre.

Për të dhënë përfitimet e pritura arsimore, teknologjia në përgjithësi dhe mjetet e rrjeteve sociale në veçanti duhet të shoqërohen me një qasje të shëndoshë pedagogjike.

Sipas hulumtimit që është bërë në shkollat e mesme në Ferizaj dhe nga rezultatet mësuam se pothuajse të gjithë nxënësit kanë një llogari në një nga rrjetet sociale dhe të gjithë përdorin të paktën një rrjet social. Facebook dhe Instagram del të jetë më i përdoruri nga nxënësit, respektivisht nga profesorët.

Nga hulumtimi mësuam se nxënësit shpeshherë i neglizhojnë mësimet e tyre dhe humbasin kohën duke u argëtuar dhe komunikuar me miqtë e tyre në rrjetet sociale.

Poashtu sipas tyre rrallëherë janë këshilluar seriozisht për përdorimin e rrjeteve sociale për qëllime edukativo-arsimore, ata për rrjetet sociale kanë mësuar nga persona tjerë dhe rrallë nëpër trajnime të ndryshme..

Nxënësit deklaruan se rrjetet sociale i përdorin edhe për të mësuar por në masë të vogël dhe vetëm atëherë kur ju duhet të zgjidhin një detyrë lidhje me mësimet e tyre.

Pavarësisht se mësime dhënësit deklaruan se gjithmonë i inkurajojnë nxënësit ti përdorin rrjetet sociale me një kohë të limituar dhe vetëm për qëllime edukativo arsimore, por përgjigjet e nxënësve tregojnë se ata rrjetet sociale i përdorin më shumë për argëtim dhe në disa raste kur ata kanë nevojë i përdorin për të mësuar apo për të zgjidhur një problem të caktuar.

Për sa i përket pyetjes rreth komunikimit ballë për ballë dhe shpërqëndrimit tek nxënësit, të dyja palët ndanë mendime të ndryshme, nxënësit deklaruan se nuk kanë vështirësi në komunikimin ballë për ballë ndërsa mendimi i mësime dhënësit ishte përafërsisht 50 me 50 që thanë se ndikojnë dhe nuk ndikojnë në komunikim ballë për ballë të nxënësve.

Koha e humbur në internet dhe rrjetet sociale nga nxënësit na tregoi se ndikon edhe tek notat e nxënësve dhe suksesi i tyre është më i dobët, andaj është e nevojshme që të këshillohen nxënësit që kohën e humbur në rrjete sociale ta shfrytëzojnë për të marrë njohuri të reja dhe për të mësuar.

Përdorimi i rrjeteve sociale nga nxënësit është edhe arsyeja multimediale, tek ata duket mjaft atraktive dhe interesante shpërndarja dhe postimi i fotove dhe videove në media sociale, ku pëlqimi dhe komentimi i tyre duket tu jep një kënaqësi dhe vetëbesim atyre.

Pra derisa ata kanë njohuri për rrjetet sociale ne duhet të gjejmë mënyra që ata ti motivojmë apo ti nxisim që rrjetet sociale ti përdorin për të mësuar dhe për të marrë njohuri të reja.

Nëse është e nevojshme të organizojmë edhe trajnime për nxënës dhe mësime lidhur me përdorimin e rrjeteve sociale në mënyrë që ora mësimore të bëhet më atraktive për ata.

Shumë prej mësuesve nuk janë në gjendje të përdorin teknologjinë në mënyrë efektive në mësime pa trajnime të mjaftueshme të llojit të duhur ose në veçanti në shkollat e mesme, për shkak të problemeve të qasjes, ose të dyja këtyre.

Përdorimet më të mira të TIK-ut sjellë përfitime të qarta për mësime dhe të mësuarit që maksimizojnë fuqinë e kompjuterit për të bërë gjëra të cilat janë të vështira ose të pamundura për të bërë në mënyra të tjera.

Mësuesit duhet të bëjnë dallimet në përdorimin e teknologjisë dhe në përdorimin e metodave tradicionale dhe ta kuptojnë se mësimi duke përdorur teknologjinë do të funksionojë më mirë dhe mësimi do të jetë më atraktiv për nxënësit.

Bibliografia

- [1] Keith (2016.) The History of Social Media: Social Networking Evolution
- [2] Erkan Bal,Huseyin Bicen(2017).The purpose of students’ social media use and determining their perspectives on education
- [3] Saleh Abdullah Alabdulkareem(2014).Exploring the Use and the Impacts of Social Media on Teaching and Learning Science in Saudi
- [4] Waleed Mugahed Al-Rahmi,Mohd Shahizan Othman: The Impact of Social Media use on Academic Performance among university students: A Pilot Study
- [5] Michael Henderson, Nicola F. Johnson “Ethics in social media”
- [6] Mr. Zeyad Amin “Ethical Issues in Online Social Networking”
- [7] Nial McCarroll, Kevin Curran(2015). Social Networking in Education
- [8] Mike Moran, Jeff Seaman,Hester Tinti-Kane(2011).Teaching, Learning, and Sharing: How Today’s Higher Education Faculty Use Social Media
- [9] Peter Osharive(2015).Social media and academic performance of students
- [10] Tarek A.El-Badawy&Yasmin Hashem(2015).The Impact of Social Media on the Academic Development of School Students
- [11] M. Owusu-Acheaw, Agatha Gifty Larson(2015).Use of Social Media and its Impact on Academic Performance of Tertiary Institution Students: A Study of Students of Koforidua Polytechnic, Ghana
- [12] Neil Selwyn(2012).Social Media in Higher Education
- [13]Lori Wade: How Social Media is Reshaping Today’s Education System
- [14] Serkan ÇANKAYA, Gürhan DURAK, Eyüp YÜNKÜL(2014).Using Educational Social Networking Sites in Higher Education: Edmodo through the Lenses of Undergraduate Students
- [15]Bernard John Kolan,Patience Emefa Dzandza(2018).Effect of Social Media on Academic Performance of Students in Ghanaian Universities: A Case Study of University of Ghana, Legon.
- [16] Raymond Owusu Boateng & Afua Amankwaa(2016).The Impact of Social Media on Student Academic Life in Higher Education
- [17] Jeffrey Paul Carpenter,Daniel G. Krutka(2015).Social Media in Teacher Education

- [18] Waleed Mugahed Al –Rahmi,Akram M.Zeki(2016).A model of using social media collaborative learning to enhance learners’performance on learning
- [19]Tanty Oktavia,Ulfah Fauziyah,Salila Hayuwirda Karin,Annisa Fathanah Sirega(2017). The influence of social media to support learning process in higher education institution: A survey perspective
- [20]Evgeny Bogdanov , Freddy Limpens , Na Li , Sandy El Helou ,Christophe Salzmann , Denis Gillet(2012).A social media platform in higher education
- [21]Abdulsalam K. Alhazmi , Azizah Abdul Rahman , Hasnain Zafar(2015).Conceptual model for the academic use of Social Networking Sites from student engagement perspective
- [22] Kristen Tarantino, Jessica McDonough, Ma Hua(2013). Effects of Student Engagement with Social Media on Student Learning: A Review of Literature
- [23] Waleed Mugahe AL-Rahmi and Mohd Shahizan Othman(2013). Evaluating Student’s satisfaction of using social media through collaborative learning in higher education
- [24] Abu Elnasr E.Sobaih,Mohamed A.Moustafa,Parvis Ghandforoush,Mahmood Khan(2016).To use or not to use? Social media in higher education in developing countries
- [25]Christine Greenhow &Cathy Lewin(2015).Social media and education: reconceptualizing the boundaries of formal and informal learning
- [26] Emad Abu-Shanab&Heyam Al-Tarawneh(2015).The Influence of Social Networks on High School Students' Performance
- [27] Ilaria Liccadi(2015).The role of social networks in students’learning experiences
- [28]Simeon O. Edosomwan(2011).The history of social media and its impact on business
- [29] K.Syamala Devi,E.Gouthami,V.Vijaya Lakshmi(2019).Role of Social Media in Teaching – Learning Process
- [30]
- <https://plato.stanford.edu/entries/ethics-social-networking/>
- [31] Christine Redecker, Kirsti Ala-Mutka and Yves Punie: Learning 2.0 - The Impact of Social Media on Learning in Europe
- [32] Source:[www.future-marketing.co.uk/social media –managment](http://www.future-marketing.co.uk/social-media-management)

[33] Source:eMarketer@statista2016

[34] Source: Itu World”Necommunication/ICT Indicators database

[35] Source:www.pearsonlearningsolutions.com

[36] Source:www.sciedu.ca/ijba

[37] Source:www.future-marketing.co.uk/social-media-management/

SHTESAT

PYETËSOR-1

I/e nderuar nxënës/e,

Ju jeni zgjedhur në mënyrë të rastësishme si një i anketuar në anketën e cila është duke u ndërmarrë si pjesë e një kërkimi arsimor në lidhje me përdorimin e rrjeteve sociale në edukim. Bashkëpunimi juaj në plotësimin e këtij pyetëso do të ju ndihmojë në suksesin e mësimit. Ju lutem mos ngurroni të jepni pikëpamjet tuaja mbi pyetjet e dhëna duke u përgjigjur të gjitha pyetjeve dhe tregoni zgjedhjen tuaj duke vendosur një shenjë para përgjigjes që ju duket më e përshtatshme, ose plotësoni boshllëqet duke dhënë arsye ose informacion në lidhje me atë pyetje. Përgjigjet do të jenë vetëm për qëllime akademike dhe do të trajtohen me konfidencialitet maksimal.

Informacion mbi të dhënat e nxënësit. Ju lutemi jepni informacione në lidhje me veten duke shënuar kutitë e duhura

- Mosha: _____
- Gjinia:
 - a. Mashkull
 - b. Femër
- Shkolla e mesme: _____

1. A keni telefon të mençur (smart phone)?

- Po
- Jo

2. A keni dëgjuar për faqet e rrjeteve sociale?

- Po
- Jo

3. Cilin nga rrjetet sociale e përdorni me shumë ?

- Facebook
- Twiter
- LinkedIn
- Instagram

- Youtube
- MySpace
- Google+
- Etj.

4. Sa kohë në ditë shpenzoni në faqet e rrjeteve sociale?

- 10 min
- 30 min
- 1-2 orë
- 2-3 orë
- 3 orë e më shumë

5. Sa kohë shpenzoni për të mësuar nga rrjetet sociale?

- 10 min
- 30 min
- 1-2 orë
- 2-3 orë
- 3 orë e më shumë

5. Rrjetet sociale i përdori për të komunikuar me miqët dhe për të ndarë informacione më të tjerët:

- Gjithmonë
- Zakonisht
- Ndonjëherë
- Rrallë
- Asnjëherë

6. Rrjetet sociale i përdorni për të postuar foto dhe video të ndryshme

- Gjithmonë
- Zakonisht
- Ndonjëherë
- Rrallë
- Asnjëherë

7. Rrjetet sociale i përdorni për të mësuar

- Gjithmonë
- Zakonisht
- Ndonjëherë
- Rrallë

- Asnjëherë

10. Ju ka treguar ndonjëri apo keni mbajtur ndonjë trajnim se si ti përdorni rrjetet sociale për mësim?

- Po
- Jo

11. Nëse po (10) cilin rrjet e përdorni për të marr më shumë njohuri rreth mësimëve?

12. A ju informojnë dhe komunikojnë me ju profesorët përmes rrjeteve sociale?

- Po
- Jo

10. Nëse i përdorni rrjetet sociale për të mësuar, a mendoni se keni marr më shumë njohuri rreth mësimëve dhe ju kanë ndihmuar të jeni më të sukseshëm në mësim?

13. A keni njohuri për abuzimet nëpër rrjetet sociale dhe ngacmimet elektronike? Na thoni ndonjë shembull qe e keni hasur.

14. A i neglizhoni mësimet e juaja duke kaluar kohën në internet?

- Asnjëherë
- Disaherë
- Shpeshherë
- Shumëherë

15. A janë në dijeni prindërit tuaj se sa kohë kaloni ju në rrjetet sociale?

- Po
- Jo

16. A mendoni ju se notat e juaja kanë qenë më të dobëta duke marr parasysh kohën që keni kaluar në internet?

- Po
- Jo

17. A besoni gjithqka që shihni në faqet e rrjeteve sociale?

- Po
- Jo

18. A mendoni se përdorimi i tepërt i rrjeteve sociale ju ka vënë në një situatë ku keni vështirësi në komunikimin ballë për ballë?

- Asnjëherë
- Disa herë
- Shpeshherë
- Shumëherë

Ju falënderoj për përkushtimin tuaj në dhënien e përgjigjeve.

PYETËSOR-2

Ju jeni zgjedhur në mënyrë të rastësishme si një i anketuar në anketën e cila është duke u ndërmarrë si pjesë e një kërkimi arsimor në lidhje me përdorimin e rrjeteve sociale në edukim. Përgjigjet do të jenë vetëm për qëllime akademike dhe do të trajtohen me konfidencialitet maksimal.

Informacion mbi të dhënat e mësimdhënësit. Ju lutemi jepni informacione në lidhje me veten duke shënuar kutitë e duhura

- Mosha: _____

- Gjinia:

- a. Mashkull

- b. Femer

2. A keni telefon të mençur (smart phone)?

- Po

- Jo

8. A keni dëgjuar për faqet e rrjeteve sociale?

- Po

- Jo

9. Cilin nga rrjetet sociale e përdorni me shumë?

- Facebook

- Twiter

- LinkedIn

- Instagram

- Youtube

- MySpace

- Google+

- Etj.

10. Cila është arsyeja që i përdorni rrjetet sociale:

- Të bisedoni me miqët

- Të merrni dhe të ndani informacione me nxënësit tuaj
- Të postoni foto dhe video të ndyshme
- Për qëllime tjera

11. A i keni inkurajuar ndonjëhere nxënësit që rrjetet sociale ti shfrytëzojnë për mësim?

- Asnjëherë
- Disahere
- Gjithmonë

12. A mendoni se shfrytëzimi i rrjeteve sociale për mësim e bën më të lehtë punën tuaj?

- Po
- Jo

13. Përdorimi i rrjeteve sociale nga nxënësit ndikon në suksesin e nxënësve:

- Negativisht
- Pozitivisht
- Nuk ndikon fare

14. A mendoni se nxënësit që kalojnë shumë kohë në rrjetet sociale kanë vështirësi në të shprehur dhe komunikim.

- Po
- Jo

15. Qka ju sugjeroni ju nxënësve, cila është mënyra e duhur për përdorimin e rrjeteve sociale?

Ju falënderoj për përkushtimin tuaj në dhënien e përgjigjeve.

